

ONKOLOGJIA



- Licensimi dhe rilicensimi i mjekëve
- Sfidat aktuale të trajtimit të pacientëve me kancer
- Onkologjia pediatrike

- Kanceri i gjirit dhe mundësitë e trajtimit në Kosovë
- Mamografia mobile
- Flow citometria si metodë moderne në diagnostikimin e leukemisë

- Patologjia molekulare
- Aksioni i AMC për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës
- Organizimi i onkologjisë në Britani të Madhe



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

www.omk-rks-org/revista_mjeku

revistamjeku@omk-rks.org

+383 49 872 300 ; +383 49 872 070, +383(0)38 544 872

QKUK, INSTITUTI A, KATI III, 10000 - PRISHTINË

LUXEMBOURG
AID & DEVELOPMENT



Kontribut të jashtëzakonshëm në themelimin dhe zhvillimin institucional të Odës së Mjekëve të Kosovës ka dhënë Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut përmes projektit për shëndetësi në Kosovë.

Përmbajtja

Faqe

Kryeredaktori: Fisnik Kurshumliu

6

Aktualitete në Odën e Mjekëve të Kosovës

Licensimi dhe rilicensimi i mjekëve

7-8

Temat e numrit

Onkologjia në një artikull

9-11

Sfidat aktuale të trajtimit të pacientëve me kancer

12-13

Shoqata e Onkologëve të Kosovës

14-15

Klinika e Hematologjisë

16

Onkologjia Pediatrike

17-18

Diagnostikimi i tumorëve në Institutin e Anatomisë Patologjike - QKUK

19-20

Bordi Nacional për Kontroll të Kancerit

21

Organizimi i Onkologjisë në Britani të Madhe

22-23

Jeta/Vita: Zbulimi i hershëm - mbijetesë

24-25

Aksioni i AMC për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës

26

Mamografia mobile

27-29

Kanceri i gjirit dhe mundësitë e trajtimit në Kosovë

30-31

Radioterapia

32-33

Këndvështrimi i onkologut mbi vaksinimin kundër SARS-COV-19 te pacientët me kancer

34-35

Onkoseksologjia

36-37

Përmbajtja

Faqe

Temat e numrit

Dermatokirurgjia tek lezionet tumorale	38-39
Patologjia molekulare në onkologjinë moderne	40-41
Mjekësia precize në onkologji: koha për një zhvendosje paradigme	42-43
Flow citometria metodë moderne në diagnostikimin e leukemisë	44-45
Kanceri i zorrës së trashë	46-48
Mamoscintigrafia	49-50
Kanceri i gjirit HER2 pozitiv	51-52
Efektet e Metformines në prevencën dhe trajtimin e kancerit	53-55

Këshilla juridike

Të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin shëndetësor	56-58
--	-------

Portreti i një mjeku

Prof.Dr.Xhavit Bicaj	59
----------------------	----

Kalendari i aktiviteteve për vitin 2021

Monument përkujtimor për nderë të profesionistëve shëndetësorë	64
--	----

Revista Mjeku
Revistë e Odës së Mjekëve të Kosovës
Vëllimi 1, Numri 2, Qershor, 2021
Publikohet 4 herë në vit

Këshilli redaktues:

Dafina Bytyqi Shabani
Elton Bahtiri
Faik Hoti
Fisnik Kurshumliu
Ibadete Bytyçi
Linda Çarkaxhiu
Luan Jaha
Lul Raka
Naser Gjonbalaj



Dafina Bytyqi Shabani



Elton Bahtiri



Faik Hoti

web faqja
www.omk-rks.org/revista-mjeku

Redaksia:

revistamjeku@omk-rks.org
+383 49 872 300
+383 49 872 070
+383 (0)38 544 872
QKUK, Instituti A, Kati III, 10000,
Prishtinë.



Fisnik Kurshumliu



Ibadete Bytyçi



Linda Çarkaxhiu
Husejin

Koordinatori ndërlidhës:
Gramoz Jakupi

Numri i radhës botohet në Shtator, 2021
Dorëshkrimet pranohen në sekretarinë e
revistës deri me datë 15 Gusht, 2021.

Te gjitha dorëshkrimet
vlerësohen nga këshilli
redaktues para botimit.

Përmbajtja e artikujve nuk reflekton
në menyre të domosdoshme qëndrimet e
këshillit redaktues.

Materialet e publikuara janë pronë e
Revistës Mjeku



Luan Jaha




Lul Raka



Naser Gjonbalaj



**Fisnik Kurshumliu**

Kryeredaktor i Revistës Mjeku

Pse është i rëndësishëm kancer regjistri ?

Luftimi i kancerit është qëllim fisnik që përfshinë mjekët, hulumtuesit, epidemiologët, specialistët e shëndetit publik, juristët dhe të tjerë. Të gjithë këta profesionistë, mbështeten në të dhëna të sakta dhe të kompletuara në përpjekjet e tyre për ta fituar luftën kundër kancerit.

Të dhënat nga kancer regjistri mundësojnë identifikimin e faktorëve ambientale të rrezikut apo sjelljeve me rrezikshmëri të lartë. Rrjedhimisht, mund të mirren masat parandaluese për zvogëlimin e numrit të rasteve me kancer dhe rasteve të vdekjeve nga kanceri.

Institucionet lokale dhe shtetërore si dhe programet e ndryshme për kontroll të kancerit përdorin regjistrin e kancerit për të hartuar strategji të shëndetit publik që rrisin efektivitetin e fondeve të dedikuara për luftimin e kancerit. Përcjellja e afatgjatë e pacientëve është gjithashtu një aspekt i rëndësishëm i kancer regjistrit përmes të cilës matet mbijetesa nga kanceri.

Rëndësia e kancer regjistrit qëndron pra, në faktin se mbledh të dhëna komplete dhe të sakta mbi kancerin. Këto përdoren për hulumtime epidemiologjike, planifikim në sferën e shëndetit publik dhe përmirësimin e kujdesit ndaj pacientit. Përfundimisht, të gjitha këto aktivitete çojnë drejt zvogëlimit të rasteve të kancerit dhe rasteve të vdekjes nga kanceri.

Regjistri shtetëror i kancerit na ndihmon që ta kuptojmë kancerin më mirë dhe t'i përdorim resurset tona në mënyrën më optimale të mundshme me qëllim të parandalimit dhe trajtimit më efikas.

Prof.Ass.Fisnik Kurshumliu, MD, PhD

Korrespondenca:

fisnik.kurshumliu@uni-pr.edu



LICENSIMI DHE RILICENSIMI I MJEKËVE



Revista Mjeku

Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK) si organizatë e pavarur profesionale që ushtron veprimtari publike dhe që i përfaqëson mjekët është themeluar më 10 nëntor të vitit 2013.

Funksionet kryesore të saj janë: licencimi dhe rilicencimi i mjekëve, organizimi i aktiviteteve me qëllim të edukimit të vazhdueshëm profesional (EVP), mbrojtja e interesave profesionale, ekonomike dhe sociale të mjekëve, mbikëqyrja e etikës profesionale të anëtarëve të saj, revokimi i licencave si dhe shërbime të tjera sa i përket komunitetit të mjekëve në Kosovë. Këto funksione janë të përcaktuara me Ligjin për Odat e Professionistëve Shëndetësor dhe Statutin e OMK-së.

EVP realizohet përmes aktiviteteve të organizuara nga institucionet shëndetësore, shoqatat profesionale dhe subjekte të tjera që kanë të bëjnë me komunitetin mjekësor.

Qëllimi është ngritja vazhdueshme profesionale në aspekt të përditësimit të njohurive të mjekëve lidhur me diagnostikimin dhe trajtimin sa më të mirë të pacientëve dhe sigurimi i pavarësisë profesionale për profesionin e mjekut.

Aktivitetet e EVP-së janë të llojllojshme, si:

- Kongrese/Konferenca (vendore, me pjesëmarrje ndërkombëtare dhe ato ndërkombëtare)
- Simpoziume (vendore, me pjesëmarrje ndërkombëtare dhe ndërkombëtare)
- Workshop/Punëtori (kurs pune, kurse demonstrative dhe kurse teorike)
- Kurse vendore të edukimit të vazhdueshëm profesional - mjekësor që ndahen në tre kategori (e parë, e dytë dhe e tretë) në bazë të vëllimit të materialit që ofrohet, përmbajtjes dhe kohëzgjatjes
- Kurse ndërkombëtare, që po ashtu ndahen në kategorinë e parë, të dytë dhe të tretë.

Për të gjitha këto aktivitete ekzistojnë kriteret strikte të përcaktuara me Rregulloren e EVP-së lidhur me fitimin e pikëve akredituese.

Vlerësimi i këtyre pikëve bëhet nga Komisioni i EVP-së që, gjithashtu, bën planifikimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të ndryshme që kanë të bëjnë me EVP.

Ky komision është i përbërë nga pesë anëtarë. Kryesohet nga Prof. Ass. Dr. Shemsedin Sadiku, kurse anëtarët e tjerë janë: Dr. Teuta Hasbata, Dr. Xhevdet Tahiraj, Dr. Violeta Binishi dhe Dr. Merita Bytyqi.

Kompetenca më të detajuara të Komisionit janë

edhe:

- Zbatimi i procedurave të veçanta administrative për evidentimin e EVP
- Përkrahja e aktiviteteve të EVP-së përmes të buxhetit të OMK-së
- Menaxhimi i regjistrimit të aktiviteteve të EVP-së
- Në bashkëpunim me Komisionin për Licencim, përcjellë evidencën e profileve profesionale të anëtarëve të OMK-së, në procesin e EVP-së;
- Kryen edhe funksione të tjera sipas nevojave për plotësimin e qëllimit të kompetencës publike për EVP-në, të bazuar në legjislacionin në fuqi.

Kryesuesi i Komisionit të EVP-së, profesor Sadiku, shpjegon se Edukimi i Vazhduar Profesional para pandemisë COVID-19 është realizuar përmes aktiviteteve të ndryshme profesionale, me prani fizike të pjesëmarrësve. Por, periudha gjatë pandemisë COVID-19, e cila në Kosovë filloi me regjistrimin e rasteve të para në mars 2020.

“Si në gjithë botën, edhe tek ne, pandemia COVID-19 u shfaqur me sfida të mëdha për komunitetin mjekësor. Megjithatë aktivitetet e ndryshme profesionale, edhe pse në numër më të vogël, filluan të mbahen përmes platformave online”

Dr. Shemsedin Sadiku

Profesor Sadiku thotë se organet vendimmarrëse të OMK-së e shqyrtuan situatën e vështirë të krijuar nga pandemia COVID-19 dhe refleksionin e saj edhe në fushën e EVP-së, prandaj u vendos për të krijuar lehtësime për mjekët në procesin e rilicencimit. “Organet vendim marrëse të Odës krijuan një rrethanë lehtësuese për grumbullimin e pikëve të nevojshme për rilicencim dhe u vendos që për vitin 2020, duke mundësuar që rilicencimi për mjekët të bëhet me minus 20 pikët e (parashikuara) të vitit 2020, pra me 80 pikë në total në vend të 100”, shpjegon ai.

OMK ka zhvilluar që nga themelimi disa aktivitete lidhur me EVP-në, ku ndër të tjera, profesor Sadiku shquan Kongresin e parë ndërkombëtar të Mjekësisë, të mbajtur në vitin 2019. *“Ky kongres ndërkombëtar ishte një ngjarje madhore dhe është vlerësuar lartë për organizim dhe cilësi të mirë”,* thotë ai.

Profesor Sadiku thekson se përpjekjet për të fuqizuar EVP-së duhet të jenë gjithnjë e më të mëdha, me qëllim të organizimit të sa më shumë aktiviteteve edukative për mjekët. *“Me rritjen e buxhetit të OMK-së, aktivitetet e ndryshme profesionale dhe edukimi i mjekëve, përfshirë edhe pjesëmarrjen në aktivitete profesionale jashtë*



Revista Mjeku

vendit, do të sponsorizohen më tepër, konform rregulloreve të OMK, me të vetmin qëllim që mjeket kosovarë të jenë në nivele sa më të larta profesionale, kurse pacientët tanë të marrin shërbime mjekësore të njëjta me ato që marrin pacientët në vendet e zhvilluara”, thotë profesor Shemsedin Sadiku.

Në kuadër të Odës, përkatësisht komisioneve të përhershme të saj, funksionon edhe Komisioni për licencim dhe rilicencim të mjekëve.

Kryetari i këtij komisioni, Prof. Ass. Dr. Ibrahim Rudhani jep disa detaje rreth punës së Komisionit për licencim dhe rilicencim dhe vet procesit.

“Me licencim nënkuptojmë dhënien e lejes së punës për përgatitjen profesionale që ka arritur mjeku, ndërsa me rilicencim vazhdimin e saj”, shpjegon ai.

Komisioni për licencim dhe rilicencim përbëhet nga 5 anëtarë që zgjidhen nga Kuvendi i Odës, të cilët shqyrtojnë dokumentacionin e mjekëve që aplikojnë për licencim ose rilicencim.

“Dokumentacioni i nevojshëm për ri-licencim është licenca e mëparshme, vërtetimi nga Komisioni i EVP-së me pikët adekuatë dhe dokumentacioni përcjellës, ndërsa numri i pikëve që duhet t'i ketë një mjek për t'u rilicencuar duhet të jetë 100. Ky 100 pikësh që duhet të arrihet brenda pesë vjetësh, nënkupton se brenda një viti, mjeku duhet të marrë pjesëmarrjes në aktivitetet të EVP-së nga 20 pikë. Përfshirë nga ky kriter është bërë nga fillimi i pandemisë COVID-19, me ç'rast mjekët janë liruar nga marrja e 20 pikëve për vitin 2020”, shpjegon profesor Rudhani.

Ai thotë se licenca e punës ka vlefshmëri në kohëzgjatje prej 5 vjetësh, përveç në raste të veçanta, kur Komisioni vendos ndryshe gjatë kohës së specializimit ose të ngjashme.

Sa u përket mjekëve jo-kosovarë, ata licencohen në Ministrinë e Shëndetësisë dhe jo në OMK, pasi të kenë dëshmuar (me dokumentacion) plotësimin e kushteve të kërkuara sipas rregulloreve përkatëse.

Sipas profesorit Ibrahim Rudhani, këtë vit në Kosovë janë ri-licencuar 110 mjekë.

Ai thekson se shëndetësia është një nga 5 shtyllat më të rëndësishme të shtetit, *“andaj, urojmë që ky sektor të vazhdojë të përkrahët e fuqizohet dhe mjekët të arrijnë suksese sa më të mira në punë”.*

Vegëza:

<https://omk-rks.org/wp-content/uploads/KO-07-2021-Rregullore-p%C3%ABr-Edukimin-e-Vazhduesh%C3%ABm-Profesional.pdf>

<https://omk-rks.org/wp-content/uploads/2020/12/KO-04-2020-Rregullore-p%C3%ABr-regjistrimin-licencimin-dhe-rilicencimin-e-mjek%C3%ABve.pdf>

ONKOLOGJIA NË NJË ARTIKULL



Elira Selimi

Gazetare e
Revista Mjeku

Klinika e Onkologjisë është një nga klinikat më të rëndësishme të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, ku trajtohen pacientët me sëmundje malinje.

Shërbimet e onkologjisë kanë filluar të ofrohen në QKUK shumë më herët, por ato kanë qenë të fragmentuara, meqë nuk ka pasur një Institut të Onkologjisë apo Klinikë të konsoliduar brenda të cilës ofrohen shumica e shërbimeve onkologjike.

Në vitin 2010 përfundimisht është themeluar kjo klinikë, e cila në fillimet e punës është përballur me vështirësi të ndryshme siç janë mungesa e stafit, mbingarkesa me pacientë, mungesat e theksuara të cito-statikëve, mungesa e objektit dhe infrastrukturës adekuate, etj.

Si pasojë e këtyre mungesave, shërbimet onkologjike kanë qenë të shpërndarë nëpër klinikat kirurgjike sipas lokacionit anatomik të tumorit (Klinika e Neurokirurgjisë, Kirurgjisë abdominale, Urologjisë, Kirurgjisë ortopedike, Gjinekologjisë, etj.)

Në vitin 2021 Ministria e Shëndetësisë miratoi formimin e Klinikës së Onkologjisë dhe që atëherë kjo klinikë ofron shërbime të Kimioterapisë, Radioterapisë, Mjekimit invaziv me kimioterapi, pastaj Laboratori për shërbime bazike, përgatitjen e cito-statikëve si dhe posedon barnatoren dhe depon e citostatikëve.

Në këtë klinikë punojnë 15 mjekë specialistë, 13 infermierë, 8 teknikë të radioterapisë dhe 3 laborantë.

Dr. Ilir Kurtishi: Onkologjia është prioritet

Drejtori i Klinikës së Onkologjisë, dr. Ilir Kurtishi, shpjegon për Revistën "Mjeku" rryjedhën e zhvillimit të këtij institucioni, me theks pas vitit 2010.

Në këtë Klinikë mund të mjekohen të gjitha tumoret solide të dy gjinive, të të gjitha sistemeve të organizmit të njeriut si: kanceret e gjirit, mushkërive, zorrës së trashë, luktshit, pankreasit, mëlçisë dhe rrugëve biliare, tumoret e trurit, melanomat dhe kanceret e lëkurës, sarcoma, tumoret e mitrës dhe qafës së mitrës, vezoreve, tumoret e prostatës, testiseve, veshkave, fshikëzës së urinës dhe llojet e tjera.

Ai thekson se ka mungesë të hapësirës në Onkologji, duke pasur parasysh faktin se në klinikë marrin shërbime onkologjike mesatarisht 130-150 pacientë në ditë, por ka raste kur edhe mbi 200 pacientë trajtohen në mënyrë ambulatorie brenda ditës aty. Shërbime 24 orëshe marrin mesatarisht 10 pacientë, derisa 70 pacientë të tjerë brenda një dite i nënshtrohen radioterapisë.

Sa i përket stafit infermerior, ai tha se është mirë i trajnuar, por edukimi i vazhdueshëm profesional infermerior duhet të vazhdojë tutje, duke përfshirë edhe qëndrimin në qendra onkologjike jashtë vendit, meqë përgatitja profesionale e infermierëve ka rëndësi të veçantë për Klinikën e Onkologjisë.

Lista e Barnave Esenciale (pjesa e citostatikëve) është pasuruar edhe me 9 ilaçe të reja, ku disa janë citostatikë bazik, barna biologjike, ndërsa dy të tjera janë barna për imunoterapi. "Por, pasurimi i Listës me ilaçe të reja është i nevojshëm gjatë viteve në vazhdim, në mënyrë që mjekimi i sëmundjeve malinje të jetë më cilësor dhe në hap me vendet e rajonit dhe botës", thotë Dr. Kurtishi.

Ai shpjegon se këtë vit për herë të parë në Kosovë, Onkologjia ka filluar me aplikimin e Brahiterapisë - rrezatimit kontakt për të sëmurët me kancer të qafës së mitrës dhe mitrës. "Teknikat IMRT, VMAT do të aplikohen për herë të parë në Kosovë falë aparatit të ri për rrezatim, i cili i është siguruar klinikës. Ky trajtim do të fillojë në fund të muajit maj ose në fillim të qershorit 2021".

Dr. Kurtishi shpjegon se deri në vitin e kaluar për trajtime jashtë vendit janë referuar pacientët për brahiterapi dhe raste të rralla për IMRT, Stereotaksis, teknikat e rrezatimit, një numër rastesh që kanë kosto të ultë, por po punohet që ky numër të jetë akoma më i vogël.

Ndërsa trajtimi i sëmundjeve malinje brenda vendit ka kosto të lartë në përgjithësi, por me punën e madhe të Klinikës së Onkologjisë është arritur që të gjitha sëmundjet malinje solide te adultët të mjekohen në Kosovë.

"Ministria e Shëndetësisë vazhdimisht e ka pasur prioritet Klinikën e Onkologjisë dhe shpresojmë që kjo të vazhdojë edhe në të ardhmen", u shpreh Dr. Kurtishi.

Dr. Arben Bislimi: Kemi rritur ndërgjegjësimin për kancer të gjirit

Kryetari i Shoqatës së Onkologëve të Kosovës (SHOK), dr. Arben Bislimi, tregon se "SHOK" është asociacion që tubon rreth vetes profesionistë të fushave të ndryshme që merren me Onkologji, me synim edukimin e vazhdueshëm profesional përmes organizimit të eventeve dhe pjesëmarrjes në to, si dhe programet e rritjes së ndërgjegjësimin për screening (egzaminim) të sëmundjeve malinje. Në këtë shoqatë punojnë dhe veprojnë rreth 60 anëtarë.

Shoqata e Onkologëve të Kosovës llogaritet lidere e fushatës së ndërgjegjësimin për kancer të gjirit, kjo nga aktivitetet e zhvilluara në kontiunitet për çdo vit gjatë të ashtuquajturit "Tetorit Rozë".

Sa i përket Klinikës së Onkologjisë, ajo nuk i plotëson nevojat dhe kërkesat e stafit, por as të pacientëve. Ordinanat dhe hapësirat ku merret terapia, sipas tij, kanë nevojë të jenë më të zgjeruara për të shmangur improvizimet.

Ai thotë se Klinika e Onkologjisë viteve të fundit është përballur me mungesën e terapisë dhe defekteve në aparatën e rrezatimit gjë që ka ndikuar direkt në punën e personelit shëndetësor me pacientë.

"Aktiviteti jonë si shoqatë me përkrahjen e mjekëve sigurisht, për sensibilizimin e popullatës për kancer të gjirit, gjatë 3 viteve, ka kaluar 90% të territorit të Kosovës, me ç'rast kanë nxjerrë rezultate fascinantë në terren", shpreh Dr. Bislimi.

Korrespondenca:
revistamjeku@omk-rks.org

Dr. Ardian Millaku: Onkologjia imponon modifikimin e komunikimit

Dr. Ardian Millaku, onkolog, i cili punon në Klinikën e Onkologjisë që nga viti 2012, tha se ndër vite kanë ndryshuar edhe kërkesat në këtë klinikë si pasojë e rritjes së rasteve të sëmundjeve malinje dhe shërbimeve që ofrohen.

“Specialistët si dhe stafi tjetër shëndetësor në Klinikën e Onkologjisë çdo ditë përballen me një fluks të madh të rasteve që kërkojnë shërbime onkologjike, por përkundër këtij vëllimi të madh të punës, secili pa përjashtim, e ushtron më këtë profesion me shumë vullnet dhe me profesionalizëm të madh”, thotë Dr. Millaku.

Sa i përket komunikimit me pacientët, ai shprehet se duhet të përshtaten dhe modifikojnë mënyrën e komunikimit, sepse duhet pasur parasysh se bëhet fjalë për sëmundje sfiduese, qoftë në aspektin emocional, psikologjik, financiar apo familjar. Ai thotë se përvojat janë të shumta, ndërsa për një onkolog është gjithmonë e rëndësishme të aplikojë atë formë të komunikimit që pacientin e bën të ndihet mirë, përkundër diagnozës.

Dr. Brunilda Profka-Haxhiu: Zbulimi i hershëm- mbrojtja më e mirë!

Dr. Brunilda Profka Haxhiu- specialiste e Onkologjisë, e intervistuar nga redaksia jonë tha se gjatë pandemisë, në klinikë janë përballur me mungesën e barnave, edhe për shkak se fokusi primar ka qenë në një drejtim tjetër, përkatësisht ballafaqimin me pandeminë COVID-19. Ajo e vlerëson si shumë të rëndësishëm komunikimin me pacientët dhe duke u bazuar në një numër të madh studimesh vëzhguese me pacientë, ato tregojnë se kënaqësia e përgjithshme që marrin këta pacientë nga komunikimi është e lartë.

“Ne si vend jemi në kontrapetal me vendet perëndimore të zhvilluara. Familjarët insistojnë vazhdimisht të mos i tregohet e vërteta pacientit. Në të kundërtën do ishte më i lehtë komunikimi afatgjatë për ata pacientë që kanë interes të dinë diagnozën e saktë. Për ne si onkologë është sa e vështirë dhe e lodhshme të kamuflujmë realitetin me pacientin dhe të kemi qasjen tjetër me familjarët”, shtoi ajo.

Në një rekomandim për pacientët dhe popullatën, dr. Brunilda Profka -Haxhiu citoi një shprehje të Makiavelit: “Fitimtari e fiton luftën shumë më parë se të zëbret në fushë- betejë, sepse në fushën e betejës luftën e kërkon ta fitoj humbësi!”. Kjo, shpjegon ajo, do të thotë që zbulimi i hershëm është mbrojtja më e mirë, sepse shpëton jetë. Për të, të jesh onkolog nuk është vetëm një punë: është më shumë se mision dhe një thirrje në të njëjtën kohë.

Dr. Faton Sermachaj: Kartela mjekësore për përcjellje efektive të ecurisë së sëmundjes

Në Klinikën e Onkologjisë vepron e punon tash e 14 vjet edhe onkologu, dr. Faton Sermachaj, i cili tha se pacientët e Onkologjisë meritojnë përmirësimin e kushteve të trajtimit në mënyrë që atyre t'u sigurohet një shërbim më cilësor, duke filluar nga sigurimi i hapësirave të mjaftueshme për trajtimin e pacientëve, po ashtu edhe shtimin e numrit të infermierëve. Ai u shpreh se hapja e kartelave mjekësore do të mundësonte përcjelljen më efektive të ecurisë së sëmundjes tek pacientët onkologjik.

Në pyetjen se cila është sfida kryesore profesionale e një onkologu, dr. Sermachaj u përgjigj se është gjetja e mënyrës së duhur për të komunikuar me pacientin, për t'ia shpjeguar një problem tejet serioz me të cilin do të ballafaqohet ai.

“Vendosja e trajtimit adekuat bazuar në diagnozën histopatologjike dhe stadifikimin përkatës është po ashtu një sfidë dhe për këtë arsye aktivizimi i konsiliumeve onkologjike multidisciplinare është i domosdoshëm”, thekson Dr. Sermachaj.

Dr. Vildane Goga: Sfida e trajtimit të rasteve të avancuara

Një ditë e zakonshme e onkologës, Dr. Vildane Goga, fillon me mbledhjen e mëngjesit (kolegjiuni), puna me pacientët në ambulancë specialiste, ku përfshihen vendimet për trajtim me terapi specifike onkologjike. Pastaj dita vazhdon me monitorimin e pacientëve gjatë marrjes së kimioterapisë, menaxhimin e efekteve anësore eventuale dhe koordinimin e stafit teknik dhe atij mjekësor në dhënie të prioriteteve të aktiviteteve ditore.

“Sfida kryesore e një onkologu është paraqitja e rasteve kancerogje shumë të avancuara, ku secili modalitet i trajtimit onkologjik është i pashpresë dhe pa mjekim. Në këto raste edhe terapia më e avancuar, përpjekjet psikoterapeutike për lehtësim janë të kota”, tha ajo për Revistën “Mjeku”.

Rekomandimi që ajo dha është që asnjë pacient të mos dorëzohet dhe ta shikojë sëmundjen si sprovë, e cila tejkalohet dhe pas kësaj, “ka urtësi që ne se njohim”.

Dr. Goga inkurajoi publikun për vizita periodike mjekësore, konform dispozitave rutinë të përcaktuara për parandalimin dhe zbulimin e hershëm të sëmundjeve, sepse stadin e sëmundjes, thekson ajo, “e kemi vet në dorë”.

Dr. Blerim Gjocaj: Suksesi i pacientëve-suksesi jonë!

Dr. Blerim Gjocaj një ndër onkologët më të ri në Klinikën e Onkologjisë, ku tash e 5 vjet punon në këtë profesion tha se furnizimi me barna është plotësuar mbi 80%, por është mesatarisht i kënaqur me këtë shifër, sepse çdo mungesë, thotë ai, krijon pritje dhe i detyron pacientët t'i gjejnë gjetiu, gjë që edhe ka ndodhur.

Ai thekson një rast nga eksperiencia e tij kur një motër medicinale ka marrë trajtim për këtë sëmundje dhe pas gjithë stresit të përjetuar në fund, i erdhën rezultatet pozitive. “Kjo na bën të ndihemi krenarë për suksesin e terapisë, që ta zbatojmë profesionin me korrektesë”. Të jetojmë jetën sa më të shëndetshme, rekomandon ai, me porosinë se “zbulimi i hershëm shpëton jetë dhe mundësia e kurimit kur sëmundja zbulohet herët është më e mirë”.

Sigurisht që në këtë artikull nuk mund të mungojnë edhe pacientët e kësaj klinike që po marrin trajtim për sëmundjet nga më të rëndat. Ata ishin të hapur për të ndarë eksperiencat e tyre me ne.

Pacientë në Klinikën e Onkologjisë për sëmundjen e kancerit të gjirit.

Dyshimet e para kishin filluar në Maj të vitit 2020 e sipas kontrollës së parë nuk ishte ndonjë gjë serioze, kjo se ishte në fillimet e para si sëmundje që po shfaqej. Kontrolla ishte bërë në Deçan.

Pas një viti teksa sëmundja veç ishte zhvilluar, e kishin drejtuar që të bëjë një operim për të hequr gjëndrrat, kjo pa bërë biopsinë e gjirit, shpjegoi pacientja.

Pas kësaj ishte drejtuar në një Klinikë private në Tiranë dhe si rredhje aty e informuan për sëmundjen që kishte. Kjo nuk ishte aspak e lehtë për tu përballuar, përshkruan momentin pacientja.

Pas konsultimeve dhe pas mbarimit të procedurave teknike filloi trajtimi kundër kësaj sëmundjeje, në Klinikën e Onkologjisë në Prishtinë. Mjekët kishin qenë të gatshëm për të na dhënë informacione për këtë sëmundje, për t'i përkrahur në çfardo kohe dhe në çfarëdo forme, si përmes telefonit ashtu edhe në kontrollat fizike që duhet të i'u nënshtrohen pacientët.

“Kostoja është e lartë për trajtimin e kësaj sëmundjeje, që nga Maji i 2020-tës kam shpenzuar rreth 4000 euro, përfshirë këtu kontrollat mjekësore, terapitë, ilaçet dhe transporti. Kjo shumë është e lartë për dikë që nuk është në një marrëdhënie pune”, tha pacientja për Revistën Mjeku.

Pacienti tjetër po vuante nga sëmundja e kancerit në mushkëri i cili ishte diagnostikuar nga fundi i muajit Shkurt të këtij viti.

“Për kontrolla nuk është se kam pritur, por për të marrë terapinë më ka ndodhur të pres rreth 2 orë” tha ai. Ndërsa për ilaçet kundër kësaj sëmundjeje nuk kishte paguar deri në gjysmën e muajit Prill, nga gjysma tjetër e tutje shpenzimet i mbulon vet pacienti, që ishte një ndër shqetësimet kryesore të këtij pacienti. Një terapi të cilës duhet të i nënshtrohet çdo tre javë, këtij pacienti i kushton 11 euro, e kishte akoma terapi të tjera për të bërë.

Kërkesë tjetër ishte shtimi i numrit të mjekëve dhe infermierëve për të dhënë terapitë, ky pacient ishte shumë i kënaqur me shërbimin e mjekëve aktual, por nga numri i madh i pacientëve që po merrnin trajtim dhe numri i vogël i mjekëve që po kryenin shërbim, shkaktohen pritje të gjata në këtë klinikë.

Në këtë Klinikë kishte edhe pacientë që nuk e dinin për sëmundjen të cilën e kishin, por familjarët të cilët ishin afër tyre u shprehën të gatshëm për të dhënë informacione për ta.

Ata thanë se për arsye personale nuk i kishin treguar pacientit për sëmundjen që kishte. Këtë vendim familjar e kishte përkrahur edhe mjeku, andaj në bashkëpunim me njëri tjetrin janë në përkujdesje të pacientit.

Duke u ballafaquar me kancerin në prostatë, qysh në dhjetor, kishte bërë vetëm dy terapi, kjo si pasojë e mungesës së ilaçeve.

“Shërbimi është i mirë, por vërehet mungesa e mjekëve, të shtohet edhe një sallë do ishte mirë meqë babai im po e merr terapinë i ulur në karrikë”, u shpreh vajza e pacientit.

Një paciente tjetër e cila po përjeton rikthimin e kancerit të gjirit, një grua e suksesshme në karrierë, përtej sfidave të sëmundjes.

Me shërbimin mjekësor është e kënaqur jashtëzakonisht shumë. Ajo duke shpjeguar përvojën e saj me sëmundjen qysh nga hera e parë e duke përfshirë edhe këtë të dytën, na tha se motivi që i kishin dhënë mjekët qysh në fillim ka pasur një rëndësi shumë të madhe dhe kjo ka bërë që të përballoj çdo sfidë deri sot.

Hera e parë i kishte kushtuar me nënshtrimin e një operacioni ku kishte hequr gjirin. Pas një periudhe të caktuar disa simptoma u shfaqën përsëri dhe po, kjo paciente po përballon me këtë sfidë për të dytën herë. Megjithatë në përditshmërinë e saj nuk kishte ndryshuar asgjë, punën dhe angazhimin e saj në jetën private e kishte pasur gjithmonë aktive.

Që nga Nëntori i 2020-tës pacientja ka kryer 9 terapi dhe tani është në përfundim të shërimit të kësaj sëmundjeje.

“Kur ke vullnet gjithçkafit ia del, e vullneti vjen nga mjeku dhe shërbimet”, tha ajo.

Eksperienca 12 mujore në Institutin Onkologjik dhe Radiologjik- Prishtinë, një tjetër rast i suksesshëm në Onkologji.

Prej 14 dhjetor 2018 e deri më 19 maj 2019 kur kishte përfunduar seancat e kimioterapisë, kishte bërë 25 seanca me rrezatim.

Është e kënaqur me punën e drejtorit të tanishëm të Onkologjisë, ajo na tregoi se në mungesë të tij puna ka vazhduar me onkologë të tjerë, të cilët poashtu kanë qenë të mirë dhe të hapur për çdo konsult që ka qenë e nevojshme. “Mjekët përveç që duhet të kujdesen për pacientët ata kanë edhe durim të madh” tha pacientja.

Pacientja shprehet optimiste për rregullimin e kushteve në këtë klinikë, si shtimi i sallave dhe ndryshimi i tualeteve.

Një mesazh për publikun: Shumica shkojnë jashtë Kosovës për trajtime, por këtu ka mjekë shumë të mirë dhe terapitë të cilat merren në Kosovë janë të njëjtat sikur edhe në shtetet tjera, përjashtuar disa raste specifike.

SFIDAT AKTUALE TË TRAJTIMIT TË PACIENTËVE ME KANCER



Ilir Kurtishi

*Drejtor i Klinikës së
Onkologjisë*

*Specialist Onkolog
Klinika e Onkologjisë
SHSKUK*

Klinika e Onkologjisë ka filluar punën në vitin 2010 njëherë si Institut i Onkologjisë, ndërsa nga viti 2011 me organogram të ri të SHSKUK-së si Klinikë. Mjekët e parë të cilët specializuan në lëmin e Onkologjisë në Kosovë në vitin 2010 janë: Dr.Vildana Goga Omega Dr.Dafina Ademi Islami, Dr Ilir Kurtishi dhe Dr Destan Azemi, ndërsa grupi i i dyte i specializanteve ishin Dr Adnan Ramadani, Dr.Naim Bardiqi, Dr.Adelina Ademi Musliu dhe grupi i tretë Dr.Faton Sermahaj, Dr.Arben Bislimi, Dr.Ekrem Hyseni dhe Dr.Ardian Millaku. Në vitin 2011 specializimin e përfundon në Shkup edhe dr Luan Krasniqi. Të gjithë specialistet e Onkologjisë diplomuan para komisionit të udhëhequr nga Profesor Xhavit Bicaj dhe Profesor Agim Sallaku. Vlen të theksohet se Profesor Xhavit Bicaj është nismëtar dhe personi kyç për fillimin e specializimit të Onkologjisë në Kosovë si dhe për ndërtimin e objektit të Onkologjisë. Profesor Bicaj ishte edhe i bartës i lëndës se Onkologjisë në Fakultetin e Mjekësisë.

Vlen të përmendet që Dr.sc. Emine Disha dhe Mr.sc. Sonja Blakaj janë 2 radioterapeutet e para të cilat menjëherë pas luftës së Kosovës në mungesë të aparatit të rrezatimit filluan të punojnë në Shërbimin e Radiologjisë- Ultratingullit të Gjirit në QKUK si specialiste edhe të radiologjisë, dhe si motër kryesore kishin Nazmije Malokun.

Në vitin 2011 punësohen të gjithë specialistet e Onkologjisë dhe merr hov puna në Klinikë ku për herë të parë bëhet rrezatimi i pacienteve me Linac akcelerator për qëllime kurative dhe paliative gjë që shënon edhe funksionalizimin e shërbimit të rrezatimit në Kosovë. Kontribut të madh për funksionalizimin e shërbimit të rrezatimit ka edhe Dr.Sc.Besim Xhafa si ekspert i fizikes mjekësore, i cili bashkë me fizikanët tjerë Prof.Dr.Gazmend Nafezin, Dr.Sc.Sead Kadirin, Mr sc Burim Uka, Fizikant Fejsal Selimi, Dr.Labinot Kastrati dhe së fundmi Mr sc Yllka Kabashi

Ndërsa shërbimi i Kimioterapisë 1 vit më herët (2010) funksionalizohet nga Dr.Mejreme Maloku si interniste-pulmologe e cila bashkë me Dr.Ibrahim Sejdiun - internist, infermieren Sellma Berani dhe një grup infermieresh e mbajnë barrën kryesore për fillimin e punës në shërbimin e Onkologjisë mjekësore.

Nga viti 2011 Klinika e Onkologjisë ka 2 shërbime të ndara, Shërbimin e Onkologjisë Mjekësore ku trajtohen të gjitha format e sëmundjeve malinje tek adultet dhe Shërbimin e Radioterapisë ku trajtohen sëmundjet malinje me rrezatim kurativ dhe paliativ.

Në vitin 2016 Klinikës i bashkëngjiten edhe 4 specialistë të rinj, Dr.Blerim Gjoci dhe Dr.Fatmire

Ademi Ramaxhiku si kemioterapeut, ndërsa në shërbimin e Radioterapisë pranohen si specialistë radioterapeut Dr.Behar Rraci, Dr.Arta Kamberi-Jusufi dhe Dr.Brunilda Profka-Haxhiu si radioterapeute e specializuar ne Tiranë. Pjesë e ekipës së Radioterapisë është edhe doktoresha e mirënjohur Dr.Gazmore Bardhi.

Sot Klinika e Onkologjisë ka 12 specialiste të kimioterapisë, 1 internist, 7 mjek radioterapeut, 6 eksperte të fizikes mjekësore, 2 Fizioterapeut, dhe 1 Psikolog klinik.

Stafi infermieror në shërbimin Onkologjisë mjekësorë numëron 25 persona, me udhëheqëse Drita Berishen ku secili nga ta kryen punë të jashtëzakonshme dhe shume profesionale, në anën tjetër në Shërbimin e Radioterapisë punojnë 10 infermier dhe teknik te radiologjisë me në krye me Dafina Kuklecin të cilët poashtu bëjnë punë të jashtëzakonshme në trajtimin e sëmundjeve malinje.

Në klinikën e Onkologjisë bëhet mjekimi ekipor i sëmundjeve malinje të të gjitha lokalizimeve duke u bazuar në protokollet ndërkombëtare siç janë ESMO, NCCN, Sent Galen e në raste të veçanta duke i adaptuar edhe sipas ilaçeve ekzistuese në listën esenciale.

Klinika e onkologjisë është e vetmja qendër gjithëpërfshirëse e onkologjisë, e cila kryen aktivitete që synojnë zhvillimin e ekuilibruar të të gjitha profesioneve shëndetësore në lidhje me trajtimin e sëmundjeve malinje. Termi gjithëpërfshirës në strukturën e tij nënkupton një veprimtari gjithëpërfshirëse terapeutike dhe diagnostike multidisiplinare.

Në sektorin shëndetësor, puna e Klinikës është e organizuar përmes 3 departamenteve: Departamenti i Onkologjisë Rrezatuese, Departamenti i Onkologjisë Mjekësore, spitali ditor dhe shërbimi 24 orë (hospitor)

Përmes lidhjeve profesionale me të gjitha disiplinat mjekësore, Klinika promovon në mënyrë adekuate cilësinë bazë që dallon onkologjinë nga degët e tjera mjekësore - multidisiplinarinë.

Klinika si qendër shërben për zbatimin e aktiviteteve shëndetësore në nivelin terciar dhe në të ardhmen edhe në fushën e arsimit, trajnimit dhe kërkimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, në fushën e onkologjisë.

Në të ardhmen si një institucion gjithëpërfshirës, Klinika duhet të drejton dhe koordinon programet e të gjitha aktiviteteve në fushën e sëmundjeve malinje, përkatësisht: parandalimin, zbulimin e hershëm (depistimin), diagnostikimin, trajtimin, kërkimin, edukimin dhe trajnimin.

Misioni i Klinikës Onkologjike është të eliminojë kancerin nga Kosova, përmes programeve të jashtëzakonshme zbulimit dhe mjekimit adekuat, dhe vizioni themelor i Klinikës Onkologjike është të mbetet institucioni kryesor onkologjik në Kosovë dhe të njihet midis qendrave të onkologjisë referuese në Ballkan.

Në fushën profesionale, qëllimi i Klinikës është të përmirësojë më tej qasjen multidisiplinare gjatë gjithë procesit të diagnostikimit dhe trajtimit të pacientëve me sëmundje malinje përmes zhvillimit të barabartë të të gjitha specialiteteve në onkologji dhe lidhjes dhe bashkëpunimit të mëtejshëm me Qendrat kryesore të Onkologjisë rajonale, Evropiane dhe SHBA .

Në fushën e arsimit, qëllimi i Klinikës është të bëhet Institucioni referues për Fakultetin e Mjekësisë dhe Shëndetësisë në Kosovë, dhe në fushën e hulumtimit, qëllimi i Klinikës është të bëhet Institucioni referues në Kosovë dhe rajon në fushën e hulumtimeve



klinike.

Nga Janari 2021, Klinika Onkologjike për herë të parë në Kosovë filloi të zbatojë Brahiterapine për sëmundje malinje të organeve gjenitale të femrës, ndërsa nga Qershori i këtij viti edhe teknikat e avancuara të radioterapisë - IMRT për neoplazitë malinje dhe beninje të të gjitha lokalizimeve sipas të gjitha kriterëve të kërkuara nga teknikat e përparuar të radioterapisë (pajisje shumë të sofistikuar - Përrshpejtuesi linear dhe stafi i trajnuar) do të përdoren për herë të parë. Në nivelin e Klinikës, një ekip për IMRT(onkolog radioterapeut dhe radiolog) do të formohet dhe i cili do të vendosë indikacione

për trajtimin e pacientëve me IMRT teknikën e radioterapisë.

Nga Maji 2021 në klinike fillon aplikimi i imunoterapisë si pjesë e listës esenciale të barnave për tumoret Pd -L1 pozitiv, edhe atë zakonisht për melanomat, por edhe për disa forma të tumorëve të ndjeshme në imunoterapi. Kjo shënon një hap përpara në mjekimin e sofistikuar të sëmundjeve malinje. Pasurimi i listës esenciale të ilaçeve për sëmundje malinje me 10 barna të reja, duke filluar na citostatiket bazik, terapia e caktuar, terapia biologjike si dhe ilaçet për mjekim të metastazave në kocka bëjnë që mjekimi i pacientëve të jetë edhe më adekuat.

Vlen të përmendet se Klinika e Onkologjisë ka punuar gjatë gjithë kohës së Pandemisë Covid-19, me intensitet të plotë, gjë që ka mundësuar që pacientët me kancer të kenë një trajtim meritues dhe në cikle të rregullta në mënyrë që sëmundja të jetë sa më shumë nën kontroll.

Edhe pse u infektuan gati të gjithë stafi i klinikës me covid-19, trajtimi i të sëmurëve ka vazhduar normalisht, pa u vërejtë mungesat e personelit, me angazhim shtesë të stafit i cili ishte i pa infektuar.

Meqenëse gjatë kësaj kohe ka pasur edhe pacient onkologjik që kanë qenë në trajtim specifik onkologjik e që janë infektuar me virus, gati të gjithë ata e kanë kaluar infeksionin si një grip të zakonshëm ose me probleme të vogla, gjë që ka qenë shumë inkurajuese si për stafin mjekësor po ashtu edhe për vetë pacientët që trajtimi i sëmundjes bazë duhet të vazhdojë.

SHOQATA E ONKOLOGËVE TË KOSOVËS



Arben Bislimi

*Kryetar i Shoqatës së
Onkologëve të Kosovës*

*Specialist Onkolog
Klinika e Onkologjisë
SHSKUK*

Themelimi

Shoqata e Onkologëve të Kosovës (SHOK) është Asociacion që tubon profesionistë të fushave të ndryshme që merren me onkologji.

SHOK është themeluar në Nëntor të vitit 1999 dmth menjëherë pas luftës, si iniciativë e profesionistëve të kohës për të asistuar dhe vepruar rreth zgjidhjes së problemeve onkologjike dhe njëkohësisht edhe edukimin profesional të anëtarëve sipas statutit të saj.

Kryetar i parë ishte Prof.Dr.Besim Sllamniku.

Duhet përmendur me krenari dhe privilegj të gjithë kontribuuesit e zhvillimit të SHOK ndër vite, shumë prej të cilëve nuk janë më në mesin tonë:

Prof.Safet Beqiri, Prof.Xhemajl Bajraktari, Prof. Binak Kastrati, Prof.Hashim Maloku, Prof.Ali Zatriqi Prof.Suzana Manxhuka Kërliu, Prof.Xhavit Bicaj, Prof.Zenel Kabashi, Prof.Behxhet Osmani, Prof.Sadri Bajraktari etj.

SHOK është themeluar me qëllim të avancimit të përgatitjes profesionale të punëtorëve shëndetësor nga lëmia e onkologjisë, organizimit të mbrojtjes onkologjike si nevojë e kohës dhe mungesës së institutit të Onkologjisë dhe bashkëpunimit me shoqata simotra në rajon dhe botë.

SHOK tani ka një adresë nga aktivizimi i Klinikës së Onkologjisë, për të vazhduar me aktivitete të shumta të edukimit dhe ndërgjegjësimit!

Shoqata e Onkologëve të Kosovës në gjirin e vetë ka anëtarësi profesionistë nga të gjitha fushat që merren me onkologji.

SHOK dhe aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm profesional

SHOK ka ruajtur kontinuitetin e organizimit të eventeve dhe takimeve profesionale me ekspert vendor dhe ndërkombëtar.

Tetor 2015 Workshop-i me pjesëmarrje ndërkombëtare në partneritet me konsorciumin Neolife nga Turqia, “Kanceri i Gjirit-sfidat e menaxhimit”

Mars 2016 Konferenca Pranverore Onkologjike: “Tumoret Solide” me ekspert nga Austria, Gjermania, Turqia dhe ata vendor.

Qershor 2016 Seminar me ligjërues nga Anglia, Austria dhe vendor : Inovacionet për tretmanin onkologjik në Radioterapi”.

Tetor 2016 Konferenca Shkencore :”Metastazat te Kanceri Gjirit”, e cila u karakterizua me numër rekord te pjesëmarrësve, mbi 1 mijë të pranishëm.

Dhjetor 2016 Takim Profesional-Seminar, me temën: ”Citostatikët-përgatitja, mënyra e aplikimit, efektet anësore dhe menaxhimi i tyre”.

Maj 2017 Konferencën Profesionale:”MELANOMA

dhe Kanceret Jomelanotike”

Shtator 2017 dhe shtator 2018 „SHOK në bashkëpunim me Repartin e Hemato-Onkologjisë Pediatrike dhe expert nga Graci i Austrisë, organizuam workshopin e 6 dhe 7 vjetor me pjesëmarrje ndërkombëtare për dy vite me radhë.

Përherë gjatë mbajtjes së çdo aktiviteti tonë, I kemi kushtuar kujdes të veçantë të nderojmë me mirënjohje kontribuuesit e shoqatës ndër vite.

Të gjitha aktivitetet tona profesionale dhe shkencore janë akredituar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Oda e Mjekëve të Kosovës sipas standardeve për edukim të vazhdueshëm profesional.

SHOK dhe bashkëpunimi me shoqatat e rajonit

(SHOK) dhe Shoqata e Onkologëve të Shqipërisë (SHOSH) organizuam së bashku Konferencën e parë Mbarëkombëtare për Kancerin e Gjirit gjatë Tetorit të vitit 2019.

Aktiviteti i cili ka zgjuar interesim të madh sepse ka tubuar profesionistë të fushës së onkologjisë nga të gjitha trojet shqiptare dhe jo vetëm.

Në këtë ditë kemi përkujtuar me krenari “post mortum” Profesorin tonë Agim Sallaku, duke qenë mirënjohës përjetësisht për kontributin që ka dhënë në edukimin profesional të brezit të parë të onkologëve në vendin tonë.

Duke parë benifitin dhe nevojën për këmbimin e përvojave vëllazërore në fushën e onkologjisë,projeksionet tona të përbashkëta janë që ky event të ketë karakter të përvjetshëm dhe të mbahet me rotacion në dy kryeqendrat tona Prishtinë dhe Tiranë.

SHOK dhe aktivitetet e ndërgjegjësimit për kancer të gjirit

SHOK së bashku me shoqatën “Jeta Vita” (Shoqatë për luftë kunder kancerit të gjirit) në vitin 2016 kemi marrë iniciativën për nisjen e fushatës për ndërgjegjësimin ndaj kancerit të gjirit në kuadër të muajit Tetor si muaj ndërkombëtar për këtë qëllim.

Gjatë 3 viteve të një pune kolosale në terren, vizituam 26 komuna dhe qendra të ndryshme anë e mbanë Kosovës.

Kjo fushatë u quajt “Tetori Rozë”, emër i cili na identifikojë për tre vite me radhë.

Ishte një angazhim i pasqor i të gjithë kolegëve nga Klinika e Onkologjisë dhe Radiologjisë në shpërndarjen e informacioneve rreth zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit.

Ishte një gatishmëri e lartë e të gjitha autoriteteve komunale për të mbarëvajtur i gjithë ky aktivitet.

Pjesëmarrja dhe interesimi nëpër komuna ishte i jashtëzakonshëm .

Në fund të çdo Tetori Rozë me Shoqatën “Jeta Vita” kemi kontribuar në organizimin e ecjes tradicionale nëpër sheshin e kryeqytetit me moton “Zbulimi hershëm, shpëton jetë”.

Dhe në fund të kësaj maratone Rozë, së bashku me Drejtoratin për Shëndetësi të Prishtinës finalizuam eventin përmblyllës në sallën e kuqe të pallatit të rinisë me numër të madh të pranishmëve dhe me sjelljen e konkluzioneve të kësaj fushate:

~Evitimi i tabuve edhe në zona më të largëta rurale për zbulim të hershëm të kancerit të gjirit.

~Nëpër të gjitha takimet tani më flitej dhe diskutohej më lirshëm për këtë temë.

~Identifikuar probleme dhe vështirësi në diagnostikim nëpër qendra të vogla të vendit, si mungesë e aparaturës dhe kuadrit.

~Arritëm të motivojmë shoqatat e ndryshme që përfaqësonin gratë për iniciativa të reja.

~Konkluzionet me rekomandime i adresuam tek organet gjegjëse vendimmarrëse duke shpresuar për reagim pozitiv.

Megjithatë 1/3 e sëmundjeve malinje mund të parandalohen duke evituar faktorët eventual të riskut, gjë e cila është një stimulim më shumë për të vepruar.

SHOK mundohet në vazhdimësi të nxisë fokusin e qeverive dhe organeve vendimmarrëse për të shtuar prioritetet e krijimit të kushteve sa më të mira për pacient dhe staf mjekësor.

SHOK dhe pandemia Covid 19.

Pandemia Covid 19, si çdo sferë të jetës ka penalizuar shumë edhe veprimtarinë tonë.

Jemi detyruar që aktivitetet të orientojmë dhe mbajmë kryesisht me platformën on-line duke respektuar masat kundër Covid-19.

Duhet theksuar se këtë vit SHOK është pjesë e organizimit të përbashkët me Odën e Mjekëve të Kosovës(OMK) të Kongresit Onkologjik që planifikohet të mbahet gjatë muajit Tetor.



SHOK dhe UICC

SHOK është anëtare e rregullt e Unionit Ndërkombëtar për Kontroll të Kancerit (UICC) me seli në Gjenevë.

SHOK për çdo vit organizon aktivitete të ndryshme senzibilizuese dhe promovuese lidhur me sëmundjet malinje në përgjithësi.

Ditën Botërore të Kancerit, SHOK dhe Klinika e Onkologjisë në mënyrë tradicionale së bashku organizojmë konferencë informuese me media për të arriturat tona të përbashkëta vjetore.

4 Shkurti shënohet si ditë Botërore e Kancerit, e cila është iniciativë e këtij unioni, si organizata më e madhe dhe më e vjetër e kancerit që angazhohet të marrë rolin udhëheqës në bashkimin e komunitetit të tillë për të zvogëluar ngarkesën globale të kësaj sëmundje.

Sot rreth 10 milion njerëz vdesin çdo vit nga kanceri, duke e bërë atë sëmundjen e dytë më vdekjeprurëse.

SHOK dhe vizioni për të ardhmen

Duke shpresuar të lirohemi sa më shpejtë nga kufizimet për arsye të pandemisë Covid, SHOK pretendojmë të vazhdojmë me krijimin e kushteve optimale për edukim të vazhdueshëm profesional për anëtarësinë tonë, duke organizuar evente dhe duke ju mundësuar ndjekjen e tyre.

Fokusi jonë gjithsesi do të jetë në zgjerimin e anëtarësimit tonë nëpër organizata simotra në Evropë dhe jo vetëm.

Aktivitetet sensibilizuese të shtrihen jo vetëm për një patologji por edhe për tjera sipas planit të screeningut.

Do të nxisim dhe japim kontributin tonë për krijimin dhe zhvillimin e programit nacional për sëmundje malinje si nevojë dhe prioritet i kohës.

SHOK do të vazhdojë të jetë e hapur për bashkëpunim me të gjithë faktorët relevantë, gjithnjë për avansimin profesional të kolegëve tonë dhe për përmirësimin e shëndetit të popullatës tonë në përgjithësi.

KLINIKA E HEMATOLOGJISË



Shemsedin Sadiku

*Profesor i mjekësisë
interne-hematologji
Fakulteti i Mjekësisë
Universiteti i Prishtinës*

*Drejtor i Klinikës së
Hematologjisë*

*Specialist i Mjekësisë
Interne-Hematologjisë
Klinika e Hematologjisë
SHSKUK*

Repartit i Hematologjisë për herë të parë është hapur me 1977, atëherë në kuadër të ish Klinikës Interne dhe themelues i parë ishte Prof.Dr.Shaban Geci.

Fillimisht repartit i Hematologjisë ishte i vendosur në katin e IV, pra në të njëjtin kat me repartin e Endokrinologjisë dhe atëherë kishte një numër të paktë të dhomave.

Shume shpejtë u pa se kërkesat për këtë patologji ishin më të mëdha, andaj u mendua se si të bëhet zgjerimi hapësinorë dhe u vendos të transferohet në katin e pestë, me një hapësirë më të madhe- gjysmën e katit, ku ndodhet edhe tani dhe gjysma tjetër mbeti për repartin e Nefrologjisë.

Puna në këtë Repart u startua me dy mjekë pastaj janë pranuar edhe tre mjekë, një në vitin 1978, një në vitin 1981 dhe një në vitin 1987. Kështu fushëveprimi i Hematologjisë ka filluar të zgjerohet në kuptimin e diagnostikës dhe trajtimit të sëmundjeve hematologjike dhe hematoonkologjike.

Ndër patologjitë e para që filluan të trajtoheshin në ish repartin e Hematologjisë, ishin Leukemite kronike (CLL, CML), Limfomat malinjë, Myeloma multiple si dhe anemitë.

Struktura nacionale e mjekëve të punësuar deri në vitin 1990 ishte gjithsej 5 mjek specialist dhe një mjek në Klinikë, e cila ende nuk kishte filluar specializimin, prej tyre pesë shqiptar dhe një serb.

Në Qershor të vitit 1990 filloi përqendrimi i situatës politike në Kosovë dhe Klinikat e Fakultetit të Mjekësisë filluan të "vërshohen" nga mjek "mbikëqyrës" të lëmive përkatëse nga Beogradi, e që në esencë kishin parasysh përgatitjen e terenit për largimin nga puna të kuadrit profesional shqiptar dhe këtë qëllim pothuaj se e arritën dhe në muajt Tetor dhe Nëntor larguan tre mjekë shqiptarë nga puna. Deri në mbarim të luftës puna në repartin e Hematologjisë ka vazhduar, kuptohet nën udhëheqjen e politikës serbe.

Menjëherë pas lufte kuadrit shqiptar i larguar nga puna rikthehet në vendin e punës dhe vazhdon punën deri në ditët e sotme. Në ndërkohë pranohen edhe dy mjekë specialiste dhe para 5 viteve poashtu pranohen edhe tre mjekë specialist.

Deri në vitin 2014 repartit i Hematologjisë ishte në kuadër të Klinikës Interne dhe nga atëherë merret vendimi që të avancohet statusi i reparteve dhe çdo repart fitoi statusin e veçantë juridik, pra avancohen në Klinikë.

Aktualisht Klinika e Hematologjisë ka të punësuar shtatë (7) mjekë specialist (Prof.ass.dr Shemsedin Sadiku-Drejtor i Klinikës; Dr Afërdita Ukimeraj-shefe e repartit; Dr Suzana Krasniqi-shefe e repartit; Dr Fitnete Gashi; Dr Fitim Gashi; Dr Erkan Krasniqi dhe Dr Viola Cavolli), kurse nga kuadri i mëhershëm ka dy Profesorë të ndjerë (Prof.dr Shaban Geci dhe Prof.dr Ahmet Brovina) dhe një profesor në pension (Prof.aosc.dr Emrush Kryeziu).

Klinika e Hematologjisë është i vetmi Institucion në Republikën e Kosovës, e cila merret me trajtimin e patologjive hematologjike dhe hematoonkologjike, aktualisht operon në një sipërfaqe prej 400 metra katrorë, e cila as për së afërmi nuk plotëson kërkesat e kësaj klinike.

Puna e cila bëhet në Klinikën e Hematologjisë është një punë mjaftë sfiduese dhe voluminoze, është një punë ekipore e cila bëhet me një përkushtim dhe profesionalizëm të lartë. Në këtë Klinikë bëhet diagnostikimi dhe trajtimi i sëmundjeve hematologjike dhe hematoonkologjike.

Numri i rasteve hematoonkologjike është mjaft i madh dhe sa për ilustrim po përmendim disa patologji më të shpeshta, ku incidenca e këtyre rasteve për një vit sillet diku me sa vijon: Lymphoma non Hodgkin 70-75 raste në vit, Lymphoma Hodgkin 15x20 raste; Leukemi kronike limfatike 15-20 raste; myeloma multiple 18-20 raste; syndrome myelodysplastike 10-12 raste; Leukemi kronike mieloidë 10-15 raste, Policitemia vera 15 raste; Trombocitemi esenciale 7-8 raste; Myelofibroza primare 7-8 raste në vit, etj.

Sfidë e veçantë është diagnostikimi dhe trajtimi i leukemive akute myeloblastike dhe lymfoblastike, ku incidence vjetore sillet diku 35-40 raste/vit.

Trajtimi i të sëmurëve hematoonkologjike në përgjithësi është mjaftë kompleks, nga se këta të sëmurë edhe ashtu janë me imunitet të kompromituar dhe trajtimi me kimioterapi pos veprimt pozitiv, edhe më tepër e dobëson imunitetin, kështu që kushtet e vendosjes – qëndrimit spitalor në Klinikën ekzistuese nuk janë aspak adekuate dhe kjo ndikon edhe në rezultatet e trajtimit. Kjo para se gjithash vlen për të sëmurët me Leukemi akute, ku trajtimi i tyre minimum duhet të bëhet në kushte gjysmë sterile, pra një i sëmurë të vendoset në dhomë të posaçme, ku ka edhe nyjen sanitare të posaçme dhe i tërë personeli shëndetësor kontaktues komunikon me mjete mbrojtëse, si mantil,maskë e kalaqë.

Duke pasur parasysh të gjitha këto vështirësi, në vazhdimisht para organeve kompetente kemi bërë kërkesë për zgjerim hapësinor të Klinikës dhe me shumë mundësi kemi arritur të bindim organet kompetente dhe është arritur ujdia, është shpallur dhe fituar tenderi për ndërtim të një objekti të ri për Klinikën e Hematologjisë (për disa shkaqe teknike ende nuk është vendosur gurëthemeli!!!), në të cilin janë të parapara pos hapësirës më të madhe dhe me komode, edhe pjesa e bllokut steril, e cila do të krijoj kushte komode për trajtimin e të sëmurëve hematoonkologjike, në rend të parë rasteve me Leukemi akute.

Në Kosovë diagnostikohen rreth 400 raste të reja me kancer të gjirit në vit. Rreth 80 prej tyre janë HER2 pozitiv. Trajtimi onkologjik specifik në Klinikën e Onkologjisë përveç me kimioterapi standarde bëhet edhe me terapi të caktuar për këtë nentip specifik të kancerit të gjirit. Në klinikën tonë pacientet kanë pasur mundësinë të marrin Trastuzumab që nga viti 2012. Revidimi i fundit i listës esenciale ka bërë që të shtohet edhe Pertuzumab tani së fundi. Këtë vit si rezultat i këtij revidimi pacientet tona me kancer të gjirit HER2 pozitiv kanë filluar të trajtohen edhe me Pertuzumab. Meqë ky nëngrup specifik karakterizohet më agresiv dhe me prognozë më të keqe, trajtimet e reja në botën e zhvilluar treguan që agresiviteti i kësaj sëmundjeje mund t'i takoj të shkuarës nëse ofrohen terapitë adekuate. Është më se i domosdoshëm aplikimi subkutan (SC) i Trastuzumab në klinikën tonë. Një aplikim i tillë do t'i bënte pacientet të ndjehen më mirë meqë do të shkurtrohej koha e qëndrimit në klinikë prej 60 minutave në 5 minuta. Në anën tjetër, duke e parë numrin e madh të shërbimeve në Klinikën e Onkologjisë, mbingarkesën e personelit shëndetësor, aplikimi subkutan do të lehtësonte shumë punën në klinikë të stafit shëndetësor. Përveç kësaj, Trastuzumab subkutan është dozë fikse për një aplikim dhe humbja e preparatit është e pamundur. Mbetemi me shpresë që në revidimet e ardhshme të listës esenciale të barërave të futën terapi tjera tani më të aprovuara për kancerin e gjirit HER2 pozitiv, të cilat kanë treguar mbijetesë më të mirë, ulje të rrikthimit të sëmundjes por edhe kualitet më të mirë të jetës.

Literatura:

1. GLOBOCAN facts and figures. http://globocan.iarc.fr/Pages/fact_sheets_cancer.aspx
2. Wolff AC, et al. ASCO/College of American Pathologists guideline recommendations for human epidermal growth factor receptor 2 testing in breast cancer. *J Clin Oncol* 2007 vol 131 p18-43
3. Press MF, et al. HER-2/neu gene amplification characterized by fluorescence in situ hybridization: poor prognosis in node-negative breast carcinomas. *J Clin Oncol* 1997 vol 15 p2894-2904
4. Campbell MR, et al. HER3 Comes of Age: New Insights into Its Functions and Role in Signaling, Tumor Biology, and Cancer Therapy. *Clinical Cancer Research* 2010 vol 16 p1373-1383
5. Perjeta neoadjuvant Roche press release. Available online at http://www.roche.com/media/media_releases/medcor-2013-10-01.htm
6. Swain SM, Miles D, Kim S-B, et al. Pertuzumab, trastuzumab, and docetaxel for HER2-positive metastatic breast cancer (CLEOPATRA): end-of-study results from a randomised, double-blind, placebo-controlled, phase 3 study. *Lancet Oncol* 2020; published online March 12. [https://doi.org/10.1016/S1473-2045\(19\)30863-0](https://doi.org/10.1016/S1473-2045(19)30863-0)
7. Minckwitz von G, Huang Ch, Mano M, Loibl S et al. Trastuzumab Emtansine for Residual Invasive HER2-Positive Breast Cancer. *N Engl J Med* 2019; 380:617-628, February 14, 2019
8. Dawood S, et al. Prognosis of Women With Metastatic Breast Cancer by HER2 Status and Trastuzumab Treatment: An Institutional-Based Review. *J Clin Oncol* 2010 vol 28 p92-98
9. Baselga J, et al; CLEOPATRA Study Group. Pertuzumab plus trastuzumab plus docetaxel for metastatic breast cancer. *N Engl J Med* 2012 vol 366 p109-119
10. Early Breast Cancer Trialists' Collaborative Group. *Lancet* 2005;365(9472):1687-717.

EFEKTET E METFORMINËS NË PREVENCËN DHE TRAJTIMIN E KANCERIT



Alberina Krasniqi

Doktor i Mjekësisë

I. Kanceri dhe ripropozimi i metforminës në fushën e kancerit

Kanceri është sëmundje në të cilën kemi ndarje të pakontrolluar, rritje abnormale të qelizave si dhe pushtim të indeve të shëndosha nga këto qeliza çfarë edhe e bën sëmundje shumë vdekjeprurëse, ku vlerësohet se afërsisht një në gjashtë njerëz vdesin nga kanceri në të gjithë botën. Për shkak të karakteristikave të tij dhe zbulimit të shpeshtë në fazë terminale, përkundër trajtimeve të shumta, beteja në luftën kundër kancerit është jo rrallë e humbur. Metformina, një bar tashmë i njohur dhe i përhshkruar si zgjedhje e parë në diabetin melit tip 2, si dhe në sindromën policistike të ovarëve, ka marrë vëmendje edhe më të madhe pasi u vërejt një lidhje mes përdorimit të saj dhe zvogëlimit të incidencës dhe mortalitetit të kancerit. Historia e saj e gjatë në përdorimin klinik e mundësoi të jetë një kandidat e shkëlqyer për ripropozim të saj për preventivë edhe trajtim të kancerit. Ripropozimi është një inovacion në farmakologjinë klinike për shkak që njohja e mekanizmit dhe sigurisë së barnave të vjetra kanë përparësi në koston më të ulët të kërkimeve shkencore dhe barnat mund të hyjnë në studime klinike më shpejt. Kjo është edhe një prej arsyeve pse i është dhënë vëmendje e madhe metforminës në fushën e kancerit.

Çfarë lidhje ka një bar antidiabetik me kancerin?

Diabeti është një prej faktorëve të pavarur prognostikë në lloje të ndryshme të kancerit si: karcinoma hepatocelulare, kanceri i pankreasit, kanceri kolorektal, kanceri i gjirit, kancerit endometrial madje edhe malinjitetet hematologjike si myeloma, limfoma non-hodgkin dhe leukemia. Si faktor i mundshëm në progresionin e tumorit është marrë roli mitogjenik i insulinës, ku me rritjen e niveleve të insulinës kemi edhe rritje të insulinës dhe faktorit rritës të ngjashëm me insulinën (I / IGF), i cili bën rregullimin e përhapjes së qelizave, diferencimin, apoptozën, transportin e glukozës dhe metabolizmin e energjisë. Gjithashtu është parë që shumë qeliza kanceroze kanë receptorë të shtuar të insulinës (IR). Prandaj, nëse diabeti si sëmundje rrit rrezikun e kancerit nënkuptohet që metformina gjatë mjekimit të diabetit, parandalon të ndodh një proces tumoroz.

II. Metformina dhe mekanizmi molekular i saj në efektin kundër kancerit

Metformina hyn në qelizë përmes OCT-1 dhe OCT-3 (transporteri organik kationik 1,3) dhe është demonstruar që ekspresioni i transportuesve të metforminës është i ndryshueshëm përgjatë linjave të qelizave të tumorit. Efektet anti-kancer të saj bazohen në: 1) aktivizimin e LKB1 dhe AMPK si dhe inhibimin e mTOR; 2) arrestimin e ciklit qelizor, stimulimin e apoptozës dhe autofagjisë; 3) inhibimin e sintezës së proteinave; 4) reduktimin e nivelit të insulinës qarkulluese; 5) pengimin e angiogenezës; 6) inhibimit të përgjigjes së proteinave të shpalosura; 7) zhdukjen e qelizave burimore të kancerit dhe 8) aktivizimi i sistemit imunitar.

Metformina vepron përmes dy rrugëve në efektet e

saj antitumoroze: 1) rrugës sinjalizuese të AMPK dhe 2) rrugës sinjalizuese të I/IGF.

Çfarë është AMPK dhe si ndalohe progresioni i tumoreve nga kjo rrugë?

AMPK apo proteinë kinaza e aktivizuar nga AMP është një proteinë kinazë e cila aktivizohet në kushte të mungesës së energjisë dhe pas aktivizimit pasojnë dy procese: 1) inhibimi i mTOR (objektivi i gjitarëve i rapamicinës) dhe 2) dëmtimi i faktorit të elongimit 2 (faktor esencial për sintezën e proteinave). mTOR është një proteinë kinazë e cila ka rol të fuqishëm në sintezën e proteinave dhe përmes kësaj në rritjen e qelizave, proliferimin dhe mbijetesën qelizore. Për më shumë, AMPK inhibon edhe rrugët sinjalizuese të EGFR (receptorit të faktorit rritës epidermal) dhe ErbB2 (onkogjeni eritroblastik B) dhe si pasojë inhibohet edhe më shumë mTOR.

Si aktivizohet rruga sinjalizuese e AMPK nga ana e metforminës?

Metformina meqënëse ul prodhimin e glukozës hepatike dhe rrit ndjeshmërinë e indeve ndaj glukozës, atëherë në këto kushte hipoglicemike nivelet e LKB1 (kinaza e mëlcisë B1) i cili është një tumorsupresorjanë të larta. Aktivizimi i LKB1 sinjalizon direkt dhe aktivizimin e AMPK. Metformina mund të pengojë gjithashtu zinxhirin e kompleksit respirator I, me këtë fosforilimin oksidativ dhe uljen e niveleve të ATP-së (adenozinë trefosfat) në qelizë si dhe ngritjen e niveleve të AMP (adenozinë monofosfatit) duke rritur raportin AMP/ATP dhe stresin oksidativ në qelizë. Me rritjen e këtij raporti aktivizohet rruga sinjalizuese e AMPK.

Si inhibohet rruga sinjalizuese I/IGF nga ana e metforminës?

Metformina rrit ndjeshmërinë e indeve ndaj insulinës dhe ul nivelet e glukozës qarkulluese në gjak prandaj kemi edhe zvogëlimin sinjifikant të insulinës pasi që nuk ka nevojë për të në këto kushte. Me uljen e insulinës në gjak kemi një kaskadë të uljes së faktorëve tjerë mitogjenikë dhe promovues të kancerit si IGF dhe hormoneve steroide duke e potencuar edhe më shumë rolin e metforminës si bar kundër kancerit.

III. Efektet antitumoroze të metforminës: Evidenca epidemiologjike

Nga një mori studimesh të bëra në incidencën dhe mortalitetin e përgjithshëm të kancerit dhe varësisht prej llojit të studimit kishte edhe rezultate variabile por si përmbledhje, metformina në krahasim me barnat e tjera antidiabetike zvogëlonte incidencën e kancerit prej 10-40% dhe zvogëlimi i mortalitetit sillëj në këto vlera. Në shumë prej këtyre studimeve u zbulua se pacientët që ishin në sekretagogët e insulinës ose në terapi me insulinë kishin gjasa më të mëdha për zhvillim të kancerave solide sesa ata në terapi me metforminë. Përdorimi i metforminës mund të shoqërohet me një ulje të konsiderueshme të rrezikut për kancerin kolorektal, kancerin e mëlcisë, pankreasit, stomakut dhe ezofagut por nuk u gjet ndonjë lidhje sinjifikante

Korrespondenca:

alberinakrasniqi96@gmail.com

midis përdorimit të metforminës dhe rrezikut të kancerit të prostatës, gjirit, veshkave, melanomës dhe kancerit të mushkërive.

e përgjithshme të përgjigjes (ORR). Nga këto hulumtime u zbulua që metformina përmirëson PFS, RFS dhe ORR. Më poshtë është paraqitur një përmbledhje me rezultate sinjifikante të metforminës nga këto hulumtime. (TABELA 1)




Fig. 1. Mekanizmat e metforminës në efektin e saj anti-kancer si dhe në frenimin e CSC (qelizave burimore kanceroze). Burimi: Saini N, Yang X (2018)

Nëse metformina si terapi e vetme ka efekt kundër kancerit, çfarë është roli i metforminës si terapi e kombinuar atëherë?

Në studimet paraklinike si dhe ato retrospektive është vërejtur një rritje e ndjeshmërisë së qelizave të kancerit ndaj radioterapisë dhe kemoterapisë pas shtimit të metforminës në terapi. Duke ditur që një nga mekanizmat e metforminës kundër kancerit është edhe dëmtimi i kompleksit I-rë të zinxhirit të transportit të elektroneve dhe me këtë rritja e raportit AMP/ATP dhe gjenerimi i ROS (specieve reaktive të oksigjenit) atëherë me gjenerimin e ROS në qelizat kanceroze dhe radioterapinë e cila dëmton ADN qelizore padyshim që ndodh vdekja e qelizave kanceroze. Gjithashtu mendohet që metformina zvogëlon nivelin e glutationit në qelizë duke mbështetur edhe më shumë mendimin që metformina ndikon në përgjigjen e saj kundër kancerit përmes stresit oksidativ dhe së bashku me kemoterapi dhe radioterapi, ky stres oksidativ i qelizave është i trefishuar.

Hulumtimet klinike të metforminës në terapinë e kancerit

Akumulimi i shpejtë i provave epidemiologjike, preklinike dhe atyre klinike për efektin antikancerogjen të metforminës i ka mundësuar metforminës të anashkalojë vlerësimin e Fazës I farmakokinetike / toksicitetit të metforminës dhe të kalojë direkt në testimin e Fazës II dhe Fazës III. Qëllimi kryesor i këtyre hulumtimeve është të përcaktohet doza maksimale e tolerueshme në pacientët e trajtuar me metforminë si dhe mbijetesën pa progresion (PFS), mbijetesën pa rekurrencë (RFS) dhe shkallën

Sa premtuese është e ardhmja e metforminës në fushën e kancerit?

Studime të shumta epidemiologjike, paraklinike dhe klinike në fazën e dytë dhe të tretë të cilat po hulumtojnë rolin e metforminës në këtë fushë vazhdimisht po shtohen, megjithatë ende ka çështje debatuese dhe punime shkencore me rezultate kundërtëse rreth këtij roli. Disa prej faktorëve të cilët mund të kenë ndikuar në këto rezultate jokonkluzive mund të jenë: numri i vogël i pacientëve të përfshirë, përfshirje e mostrave më të vogla të pacientëve jodiabetikë dhe atyre me kontroll ndaj glicemisë, mospërshtatja e indeksit të masës trupore, moshës si dhe faktorëve të rrezikut, numri i vogël i hulumtimeve të randomizuara etj. Edhe pse ka studime kundërtëse një numër i madh i hulumtimeve zbuluan që metformina është bar i dobishëm në uljen e incidencës dhe mortalitetit të përgjithshëm të kancerit si dhe kancerit në organe specifike. Një numër i studimeve vërejtën që radioterapia dhe kemoterapia e kombinuar me metforminë dha përgjigje edhe më të mirë në trajtim të kancerit.

Duke qenë se metformina është bar i lirë, me efekte minimale anësore, me histori të gjatë në eksperiencën klinike atëherë ajo është një opzion mjaftueshëm komplementar në terapinë e kancerit. Sfidë e përdorimit të këtij bari në të ardhmen do jenë polimorfizmat gjenetikë dhe stimulimi i ekspresionit të transporterëve membranorë të metforminës (OCT-1,3) por pas këtij rishikimi ne jemi konfidentë të themi që e ardhmja e metforminës në fushën e kancerit është mjaft premtuese.

Literatura:

1. Saraei P, Asadi I, Kakar MA, Moradi-Kor N. The beneficial effects of metformin on cancer prevention and therapy: a comprehensive review of recent advances. *Cancer Manag Res.* 2019
2. Cai H, Zhang Y, Han TK, Everett RS, Thakker DR. Cation-selective transporters are critical to the AMPK-mediated antiproliferative effects of metformin in human breast cancer cells: Transporters in metformin effect against breast cancer cells. *Int J Cancer.* 2016
3. Decensi A, Puntoni M, Goodwin P, Cazzaniga M, Gennari A, Bonanni B, et al. Metformin and cancer risk in diabetic patients: a systematic review and meta-analysis. *Cancer Prev Res (Phila).* 2010
4. Stevens RJ, Ali R, Bankhead CR, Bethel MA, Cairns BJ, Camisasca RP, et al. Cancer outcomes and all-cause mortality in adults allocated to metformin: systematic review and collaborative meta-analysis of randomised clinical trials. *Diabetologia.* 2012
5. Thakkar B, Aronis KN, Vamini MT, Shields K, Mantzoros CS. Metformin and sulfonylureas in relation to cancer risk in type II diabetes patients: a meta-analysis using primary data of published studies. *Metabolism.* 2013
6. Yu H, Zhong X, Gao P, Shi J, Wu Z, Guo Z, et al. The potential effect of metformin on cancer: An umbrella review. *Front Endocrinol (Lausanne).* 2019
7. Heckman-Stoddard BM, DeCensi A, Sabasrabudhe VV, Ford LG. Repurposing metformin for the prevention of cancer and cancer recurrence. *Diabetologia.* 2017
8. Zi F, Zi H, Li Y, He J, Shi Q, Cai Z. Metformin and cancer: An existing drug for cancer prevention and therapy (Review). *Oncol Lett.* 2017
9. Jiralalaspang S, Palla SL, Giordano SH, Meric-Bernstam F, Liedtke C, Barnett CM, et al. Metformin and pathologic complete responses to neoadjuvant chemotherapy in diabetic patients with breast cancer. *J Clin Oncol.* 2009
10. Saini N, Yang X. Metformin as an anti-cancer agent: actions and mechanisms targeting cancer stem cells. *Acta Biochim Biophys Sin.* 2018, 50(2), 133–143

Studimi	Tipi i kancerit	Pjesëmarrësit	Intervenimi	Përfundimi
NCT01101438 Hulumtim i rando- mizuar në fazën e tretë të metforminës kundrejt placebo në kancerin e hershëm të gjirit	Kanceri i gjirit	3649 pjesëmarrës, nga mosha 18 deri në 74 vjeç	Bari: metforminë Të tjera: placebo	Metformina përmirësoi PFS-në e pacientëve (PFS- progesion free survival)
NCT01666730 Një studim i fazës II të metforminës plus FOLFOX 6 të mod- ifikuar në pacientët me kancer pankreatik metastatik	Adenokarcinoma e pankreasit	50 pjesëmarrës; mbi 18 vjeç	Bari: metformi- na,oxaliplatin, kalci- um leucovorin, dhe fluorouracil	Metformina përmirësoi PFS dhe OS të pacientëve (OS-overall survival)
NCT02437656 Studimi i fazës II që vlerëson efikasitetin e kombinimit të metforminës me radiokemoterapinë neoadjuvante në trajtimin e kancerit të zorrës të avancuar lokalisht	Kanceri rektal	60 pjesëmarrës mbi 18 vjeç	Bari:metformina	Metformina ka përmirësuar shkallën e ruajtjes së sfinkterit të pacientëve (SPR)
NCT03118128 Efekti i shtimit të metforminës në prognozën e pa- cientëve me leukemi limfoblastike akute	Leukemia akute limfoblastike	102 pjesëmarrës mbi 18 vjeç	Bari: metformina (metformina plus prednizoni në një cikël 7-ditor si para-trajtim dhe gjatë 28 ditëve trajtimin e induksionit të remi- sionit)	Efekte përfituese të metforminës në sh- kallën e relapsit dhe RFS të pacientëve (RFS-relapse free survival)
NCT01579812 Një vlerësim i fazës II të metforminës, duke synuar qelizat burimore të kancerit për parandalimin e relapsit në pacientët me kancer ovarian, të tubit fallopian dhe kancerin primar peritoneal në fazën IIC / III / IV	Kanceri ovarian,i tubit fallopian dhe kanceri primar peritoneal	90 pjesëmarrës nga 19 vjeç deri në 79 vjeç	Bari: metforminë	Metformina përmirësoi RFS- në e pacientëve (RFS-relapse free survival)

TABELA 1- Një përmbledhje e studimeve të hulumtimeve klinike të efekteve të metforminës në kancer



Revista Mjeku

Këshilla Juridike

Ligji nr.2004/38 - për të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin shëndetësor

Neni 4 - E drejta në kujdes cilësor shëndetësor

4.1. Çdo banor ka të drejtë, për kujdes shëndetësor që është i kushtëzuar me gjendjen e tij të shëndetit. Kujdesi shëndetësor duhet të jetë adekuat, me qasje në vazhdimësi për të gjithë dhe pa diskriminim.

Neni 5 - E drejta e zgjedhjes

5.1. Banori ka të drejtë, që të konsultohet dhe të trajtohet nga mjeku, të cilin e zgjedh vetë, me pëlqimin e institucionit shëndetësor, brenda kufijve të përcaktuar me ligj dhe rregullat operative të institucionit. 5.2. Banori mund të kërkojë që të ekzaminohet nga konziliumi mjekësor brenda institucionit në lidhje me: çfarëdo diagnoze të vënë ose terapie të rekomanduar nga mjeku përgjegjës; lëshimin e planifikuar nga institucioni shëndetësor me shtretër, ose dërgimin te institucioni tjetër shëndetësor.

Neni 9 - E drejta për të qenë i informuar

9.1. Banori ka të drejtë që të pranojë informatën e plotë, në një formular individual.

9.2. Banori ka të drejtë, që të pranojë informata të detajizuara lidhur me:

- a. gjendjen e shëndetit të tij, përfshirë këtu edhe vlerësimin mjekësor;
- b. ekzaminimet dhe intervenimet e rekomanduara;
- c. përparësitë e mundshme dhe rreziqet e realizimit të ekzaminimeve ose të intervenimeve të rekomanduara;
- d. datat e planifikuara për realizimin e ekzaminimeve dhe të intervenimeve;
- e. të drejtën e tij, për të vendosur lidhur me ekzaminimin ose intervenimin e rekomanduar;
- f. procedurat dhe metodat e mundshme alternative;
- g. rrjedhën e ofrimit të shërbimeve si dhe rezultatet e pritura;
- h. suksesin ose dështimin eventual të çfarëdo ekzaminimi ose intervenimi të përfunduar, përfshirë edhe rezultatet që dallojnë nga ato të pritura, si dhe shkaqet për këtë;

i. mënyrat e rekomanduara për jetë të shëndoshë dhe j. çdo informatë tjetër, relevante për shëndetin e banorit ose për trajtimin e tij.

9.3. Banori ka të drejtë që të disponojë me emrat, kualifikimet dhe pozicionet e personave që janë të përfshirë drejtpërdrejt në procesin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për të.

9.8. Banori, i cili ka aftësi të plotë veprimi, mund ta refuzojë të drejtën për të qenë i informuar, përveç në rastet kur ai duhet që, patjetër, të jetë koshient për natyrën e sëmundjes, me qëllim që të mos e rrezikojë shëndetin e të tjerëve.

9.11. Banori ka të drejtë që të informohet edhe në rastet kur pëlqimi i tij, nuk është kusht për fillimin e trajtimit.

Neni 10 - E drejta e vendimit personal

10.1. Banori, ka të drejtë që të vendosë se a do t'i nënshtrohet ose jo trajtimit të caktuar. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm në mënyrën e përcaktuar me ligj.

10.2. Brenda kornizës së realizimit të së drejtës të vendimit personal, banori është i lirë që të vendosë se a dëshiron që të shfrytëzojë shërbimet shëndetësore apo jo, si dhe me cilat intervenime të pajtohet dhe cilat intervenime t'i refuzojë, duke pasur parasysh kufizimet e përcaktuara me ligj.

10.5. Në rast të intervenimeve invazive është i domosdoshëm pajtimi me shkrim i banorit ose në rast se banori nuk është në gjendje që ta bëjë këtë, deklarata e tij, gojore ose deklarata e dhënë në ndonjë mënyrë tjetër, në praninë e njëkohshme të dy dëshmitarëve.

10.6. Banori mund ta tërheqë, në çdo kohë, pëlqimin e tij, për realizimin e intervenimit të caktuar. Me rastin e tërheqjes së pëlqimit pa arsytim të mjaftueshëm, banori mund të jetë i obliguar që të kompensojë shpenzimet e arsyeshme, që janë bërë si pasojë e këtij veprimi.

14.1. Pëlqimi me shkrim i banorit, kërkohet për shfrytëzimin e cilësdo nga: qelizat, përbërjes së qelizave, indeve, organeve ose të pjesëve të trupit, që largohen nga banori, për së gjalli, nëpërmjet intervenimit, që nuk i ka shërbyer qëllimit për të cilin ai, fillimisht ka dhënë pëlqimin. Për shkatërrimin e rëndomtë të këtyre materialeve, nuk nevojitet të merret pëlqimi i banorit. 14.2. Banori ka të drejtë, që të vendosë për cilindo intervenim që është i lidhur me trupin e tij, pas vdekjes, brenda kufizimeve të përcaktuara me ligj.

Neni 15 - E drejta e refuzimit të dhënies së pëlqimit

15.1. Me përjashtim të kushteve të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 si dhe rasteve të definuara në paragrafin 6, të këtij neni, banori me aftësi të plotë të veprimi, ka të drejtë që të refuzojë dhënien e pëlqimit, përveç në rastin kur me këtë, do të rrezikojë jetën ose sigurinë fizike të të tjerëve.

15.2. Çfarëdo refuzimi i dhënies së pëlqimit, për të cilin vlerësohet se do të dëmtojë në mënyrë serioze ose të përthershme shëndetin e banorit, mund të zbatohet nga ana e banorit vetëm nëpërmjet deklaratës publike, deklaratës së plotë dhe përfundimtare private ose në rast pamundësie për të shkruar, deklaratës së dhënë në praninë e njëkohshme të dy dëshmitarëve. Në rastin e fundit, refuzimi i dhënies së pëlqimit, duhet të evidentohet në dokumentacionin shëndetësor të banorit dhe duhet të vërtetohet me nënshkrimin e të dy dëshmitarëve.

15.3. Intervenimet jetëpërkrahëse ose jetëshpëtuese, mund të refuzohen, duke lejuar që sëmundja të ketë

rrjedhën e saj të natyrshme, vetëm atëherë kur banori lëngon nga sëmundja serioze, që është e pashërueshme dhe kur është e sigurt se kjo sëmundje, bazuar në të arriturat e fundit të shkencës mjekësore, do të shkaktojë vdekjen, brenda një periudhe të shkurtër kohore, edhe në rast se ofrohet kujdesi plotësisht adekuat shëndetësor. Refuzimi i intervenimeve jetëpërkrahëse ose jetëshpëtuese mund të bëhet, duke i respektuar procedurat formale, të definuara në paragrafin 2 të këtij neni.

15.4. Refuzimi i dhënies së pëlqimit, në mënyrën si është definuar në paragrafin 3, mund të jetë i vlefshëm vetëm në rast se Komisioni, i përbërë nga tre mjekë, e ekzaminon banorin dhe merr vendim unanim, të cilin e shpreh në formë të deklaratës me shkrim, me të cilën vërteton se banori, me rastin e refuzimit të dhënies së pëlqimit, ka qenë plotësisht koshient për pasojat e këtij vendimi dhe se, me këtë rast, kushtet e definuara në paragrafin 3, janë përmbushur. Ditën e tretë, pas dhënies së deklaratës nga ana e Komisionit mjekësor, banori sërish – në praninë e dy dëshmitarëve – duhet të deklarojë refuzimin e dhënies së pëlqimit. Në rast se banori nuk pajtohet që t'i nënshtrohet ekzaminimit të Komisionit mjekësor, deklarata e tij, lidhur me refuzimin e trajtimit mjekësor, mund të mos merret në konsiderim.

15.7. Në rastin e refuzimit, siç është definuar në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, duhet bërë përpjekje që, nëpërmjet intervistës personale, të kuptohen shkaqet e vendimit të këtyre të banorit dhe të tentohet që ky vendim të ndryshohet. Gjatë kësaj, si shtesë informatës së definuar në nenin 9, banori duhet të informohet edhe një herë mbi pasojat e moszbatimit të intervenimit.

15.8. Banori mundet, në çdo kohë që, të tërheqë deklaratën lidhur me refuzimin e dhënies së pëlqimit, pa asnjë kufizim, sa i përket mënyrës se si mund ta bëjë këtë.

Neni 17

17.1. Banori, me aftësi të plotë veprimi, mundet që në rastin e mundësisë për humbjen e mëvonshme të aftësisë së tij të veprimit, në deklaratë publike të refuzojë pëlqimin për:

a. disa ekzaminime ose intervenime të përcaktuara në paragrafin 15.1;

b. intervenimet e përcaktuara në paragrafin 15.3, dhe

c. intervenimet e caktuara jetëpërkrahëse ose jetëshpëtuese, nëse vuan nga ndonjë sëmundje e pashërueshme dhe si pasojë e sëmundjes është i paaftë për t'u kujdesur fizikisht për veten, ose nëse ka dhimbje, që nuk mund të pakësohen me gjithë terapinë përkatëse.

Neni 19 E drejta e qasjes ndaj dokumentacionit shëndetësor

19.8. Pas përfundimit të trajtimit mjekësor të banorit, vetëm personi i autorizuar nga ai, me deklaratë të plotë dhe përfundimtare private, është i autorizuar që të ketë qasje në dokumentacionin shëndetësor dhe të nxjerrë kopje të tij.

19.9. Në rast se banori vdes, përfaqësuesi i tij ligjor, i afërmi i ngushtë dhe trashëgimtarët, janë të autorizuar, që të njoftohen me të dhënat e institucionit shëndetësor, që kanë pasur ose mund të kenë pasur lidhje me shkakun e vdekjes, me trajtimin mjekësor të zbatuar para vdekjes, si dhe të kenë qasje në dokumentacionin shëndetësor; kopjet nga dokumentacioni shëndetësor, mund të nxjerren me shpenzime personale.

Neni 20 - E drejta e ruajtjes së konfidencialitetit dhe aspektit privat të të dhënave shëndetësore

20.1. Banori ka të drejtë në ruajtjen e konfidencialitetit dhe përmasës private të të dhënave personale; të informatave që janë të lidhura me gjendjen e tij shëndetësore; trajtimin mjekësor si dhe çdo informate tjetër, që përmban dokumentacioni i tij shëndetësor.

20.2. Banori, është i autorizuar, që të bëjë deklaratë përkitazi me atë se kush mund të marrë informata mbi sëmundjen e tij dhe prognozën e saj, si dhe kush nuk ka të drejtë të jetë i njoftuar plotësisht ose pjesërisht mbi të dhënat e shërimit të tij.

Neni 21 - PËRGJEGJËSITË E BANORIT

21.1. Gjatë shfrytëzimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, banori duhet t'i respektojë dispozitat ligjore, të lidhura me to.

21.2. Nëse këtë e lejon gjendja shëndetësore banorit, varësisht nga aftësitë dhe njohuritë e tij banori duhet të bashkëpunojë me punëtorët shëndetësorë, të përfshirë në trajtimin mjekësor, në mënyrat si vijon:

a. informimi mbi të gjitha detajet e domosdoshme për përcaktimin e diagnozës, përgatitjen e planit të trajtimit dhe për kryerjen e intervenimeve të nevojshme; posaçërisht informimi i punëtorëve shëndetësorë, për çdo sëmundje të mëhershme, trajtimin shëndetësor, përdorimin e barnave ose për prodhimet dhe procedurat paramjekësore, si dhe për afinitetin e tij ndaj faktorëve të rrezikshëm, që mund të dëmtojnë shëndetin;

b. informimi për çdo detaj në lidhje me sëmundjen e tij, që mund të rrezikojë sigurinë jetësore ose fizike të të tjerëve, në veçanti mbi ndonjë sëmundje ngjitëse ose mbi ndonjë sëmundje ose gjendje që e përjashton atë nga ushtrimi i profesionit;

c. lajmërimi i personave nga të cilët mund të ketë marrë sëmundjen ngjitëse si dhe të

personave, të cilët mund t'i ketë infektuar, në rastin e sëmundjeve ngjitëse;

d. informimi për të gjitha deklaratat e mëparshme, të dhëna në kuadër të procedurave ligjore, që kanë lidhje me sëmundjen ose çrregullimin, për të cilën ofrohet kujdesi shëndetësor;

e. t'u përmbahet udhëzimeve, të marra në lidhje me trajtimin mjekësor;

f. respektimi i rregullave operative të institucionit shëndetësor;

g. pagesa e bashkëpagesave dhe e çmimeve të tjera;

h. prezantimi i provave të besueshme për të dhënat personale.

Neni 24 - Ankesat e banorëve

24.1. Banori ka të drejtë të parashtojë ankesë ndaj institucionit shëndetësor përkitazi me shërbimin shëndetësor që i është ofruar, jo më vonë se 60 ditë pas shkakimit të incidentit.

24.2. Institucioni shëndetësor duhet të bëjë hetime lidhur me pohimet në ankesë dhe duhet të informojë banorin mbi rezultatet e hetimeve me shkrim, brenda 10 ditëve të punës.

Neni 26 - Kërkesat e banorëve për dëmshpërblim

26.1. Banori ka të drejtë të parashtojë kërkesë për dëmshpërblim, mbështetur në përgjegjësinë civile të institucionit shëndetësor për dëmtimin e shëndetit të tij gjatë trajtimit mjekësor, jo më vonë se brenda një viti prej momentit kur është bërë koshient për dëmin e shkakuar.

Neni 28

28.2. Kërkesa e banorit duhet të shqyrtohet brenda periudhës tremujore, ndërsa vendimi i Komisionit lidhur me të, duhet t'i dorëzohet banorit me shkrim.

Neni 33 - Ankesa kundër vendimit të Komisionit

Kundër vendimeve të Komisionit mund të ushtrohet ankesa në gjykatën kompetente, në përputhje me ligjet përkatëse.

MINISTRIA E SHËNDETËSISË - Karta e të Drejtave dhe Përgjegjësisë të Pacientit UA 15/2013

11. E drejta për shmangie të vuajtjeve dhe dhimbjeve

Çdo qytetar ka të drejtë për të shmangur, sa më shumë të jetë e mundur, dhimbjen dhe vuajtjen në çdo fazë të sëmundjes së tij.

KODI I ETIKËS DHE DEONTOLOGJISË MJEKËSORE

Neni 24 – Përkushtimi dhe sjellja

Mjeku duhet t'i garantojë të sëmurit

përkushtim, sjellje të mirë dhe kompetencë profesionale. Ai e ka për detyrë t'i dedikojë të sëmurit të gjithë kohën e domosdoshme për informimin e tij dhe marrjen e vendimeve diagnostike e mjekuese sa më të drejta. Mjeku duhet të përmbushë misionin e tij me respekt dhe zbatim të standardeve profesionale dhe etike, pa abuzuar mbi të sëmurin nga ana fizike, emocionale ose materiale. Atij nuk i lejohej t'i imponojë të sëmurit opinionet e tij personale, filozofike, morale ose politike.

Neni 30 – E drejta e të sëmurit për t'u informuar

I sëmuri ka të drejtë të informohet për sëmundjen, ekzaminimet dhe mjekimet që I propozohen dhe rezultatet e tyre. Mjeku e ka për detyrë ta informojë të sëmurin në mënyrë të sqartë dhe të kuptueshme, duke marrë parasysh në çdo rast personalitetin dhe gjendjen e tij .

Nëse i sëmuri është nën 16 vjeç apo I paaftë për të kuptuar gjendjen dhe mjekimin që I propozohet, informacioni i jepet familjarit më të afërt që e ka nën kujdestari. Nëse mjeku gjykon se duke informuar të sëmurin rrezikon të dëmtojë gjendjen e tij psikik e shëndetësore, atëherë ai nuk është I detyruar ta informojë e as ta njohë me dokumentacionin mjekësor. Një diagnozë e rëndë dhe prognozë fatale mund të zbulohet me shumë maturi. Gjithsesi familjarët duhet të jenë të informuar dhe paralajmëruar, përveçse, nëse vetë i sëmuri i ka përcaktuar më parë personat të cilët mund të informohen për gjendjen e tij.

Neni 35 – Vazhdimësia e mjekimit (ofrimi i shërbimeve shëndetësore jashtë orarit të punës)

Në çfarë do rrethanash qoftë, mjeku e ka për detyrë të sigurojë vazhdimin e mjekimit të sëmurit të tij. Edhe në rast të një rreziku publik, mjeku nuk duhet të braktisë të sëmurit e tij, veçse me Urdhër nga autoritetet përgjegjëse në përputhje me Ligjin.

Në rastet kur mjeku do të largohet dhe do të lerë detyrën për një kohë, apo kur ai e gjykon se problemet apo gjendja shëndetësore e të sëmurit dalin jashtë aftësive dhe njohurive të tij profesionale, apo jashtë mundësive të tjera për ta trajtuar, atëherë mjeku e ka për detyrë të marrë të gjitha masat që i sëmuri të kalojë për të vazhduar mjekimin tek një mjek tjetër I fushës përkatëse i aftë për të marrë përsipër këtë trajtim.

Neni 36 – Ndërrimi i mjekut kurues

Mjeku ka të drejtë të heq dorë apo të refuzojë vazhdimin e mjekimit të sëmurit dhe të rekomandojë trajtimin e tij tek një mjek apo institucion tjetër në këto raste:

- a. Për arsye profesionale apo personale;
- b. Kur i sëmuri, i aftë dhe I ndërgjegjshëm për

të marrë vendime të pavarura, humb besimin tek mjeku; dhe

c. Kur i sëmuri, i cili është koshient, sillet në mënyrë të pahijshme, bëhet brutal dhe kërcënues ndaj mjekut.

Edhe në këto raste, nëse i sëmuri përbën urgjencë mjekësore, mjeku e ka për detyrë t'i ofrojë ndihmën mjekësore deri në kapërcimin e situatës apo të ketë siguruar vazhdimin e trajtimit nga një mjek tjetër.

- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore jashtë orarit të punës është rregulluar me ligjin e Punës si në vijim;

LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS

Neni 23 Puna më e gjatë se orari i plotë i punës

1. Në raste të jashtëzakonshme, me rritjen e vëllimit të punëve dhe në raste të tjera të domosdoshme, me kërkesën e punëdhënësit, punëtori duhet të punojë me gjatë se orari i punës (puna jashtë orarit), më së shumti deri në tetë (8) orë në javë.

2. Puna më e gjatë se orari i plotë i punës, në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, mund të zgjasë vetëm për aq kohë sa është e domosdoshme.

3. Puna që e tejkalon kufirin e përcaktuar sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të bëhet edhe në rastet emergjente për parandalimin e aksidenteve ose forcave madhore të paparashikuara.

4. Përveç punës shtesë të detyrueshme nga paragrafi 1. i këtij neni, i punësuarit mund të bëjë punë shtesë vullnetare në marrëveshje me punëdhënësin, me kompensim page sipas nenit 56 të këtij ligji.

5. Ndalohet puna jashtë orarit për të punësuarit nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç.

6. I punësuarit i cili punon me orar të shkurtuar të punës nuk mund të punojë më gjatë se orari i plotë i punës.

7. Punëdhënësi është i obliguar të mbajë të dhëna të sakta për punët jashtë orarit dhe t'i prezantojë ato sipas kërkesës së Inspektoratit të Punës.

8. Inspektori i Punës ndalon punën jashtë orarit, nëse ajo ndikon dëmshëm në shëndetin dhe aftësinë punuese të të punësuarit.

9. Punëdhënësi është i obliguar të shpallë orarin e punës në vend të dukshëm.

- Në rastet kur i punësuarit nuk respekton kontratën e punës të lidhur me punëdhënësin, konsiderohet se ka kryer veprë penale apo mund të jetë i dyshuar për kryerjen e veprës penale sipas nenit 218 - Cenimi i të drejtave në marrëdhëniet e punës të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

Literatura:

Ligji nr.2004/38 - për të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin shëndetësor;

<https://gjk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2454>

Ministria e Shëndetësisë - Karta e të Drejtave dhe Përgjegjësi të Pacientit UA 15/2013;

<http://prak-kosova.org/wp-content/uploads/2018/08/Karta-e-te-Drejta-te-Pacienteve-ne-Kosove.pdf>

Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore;

<https://omk-rks.org/wp-content/uploads/2020/01/KO-32-2019-Kodi-Etik-i-OMK-s%C3%AB.pdf>

Ligji nr.03/L-212 i Punës;

<https://gjk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735>

Prof.Dr.Xhavit Bicaj

Mjek, radiolog, doktor i shkencave dhe profesor. Lindi me 23 dhjetor 1949 në fshatin Vrellë, komuna e Istogut. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Istog. Diplomoi në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd më 1975. Pas diplomimit punësohet në Banjë të Pejës, më pas në Podujevë dhe në vitin 1976 punësohet në Institutin e Radiologjisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Specializimin nga lëmia e Radiologjisë e kreu më 1980. Më 1981 zgjidhet asistent i lëndës Radiologjia në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Me 8 mars 1985 për herë të parë në Kosovë themelon shërbimin e Radioterapisë kontakte. Më 1986 mbron temën e magistraturës me titull "Morbiditeti spitalor nga sëmundjet malinje ne Kosovë". Në vitin 1993 për herë të parë hap kabinetin privat të Radiologjisë diagnostike në Prishtinë. Më 1998 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë mbron tezën e doktoratës me titull: "Trajtimi radioterapeutik i kancerit të lekurës". Ka marrë pjesë në shumë kongrese e simpoziume dhe ka publikuar mbi 40 punime si autor dhe koautor. Në vitin 2000 në kuadër të SHKKK-së themelon Shërbimin Mjekësor (Ryder Kosova) për trajtimin e të sëmurëve nga sëmundjet malinje në fazën terminale të sëmundjes. Në vitin 2003 ka botuar dy monografi nga fusha e trajtimit të dhimbjes: "Qetësimi i dhimbjes" dhe "Trajtimi i të sëmurëve malinj në fazën terminale të sëmundjes". Më 2004 zgjidhet shef i Katedrës së Radiologjisë. Është pensionuar dhe jeton në Prishtinë.



Literatura:

Prof. Dr. Isuf Dedushaj: "Enciklopedia e doktorëve të shkencave të mjekësisë shqiptare gjithandej globit (1445-2019), dhe mjekëve që lanë gjurmë të pashlyera në historinë e mjekësisë shqiptare, OMK, Prishtinë 2019.

Pjesë nga biografia e Prof.Dr.Bicajt.

Kalendari i aktiviteteve për vitin 2021

Institucioni/Shoqata organizuese e aktivitetit	Tema	Koha e mbajtjes së aktivitetit
Qendra e Mjekësisë Urgjente - Prishtinë	Ligjërata vjetore profesionale	Gjatë gjithë vitit 2021
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Obiliq	Ligjërata vjetore profesionale	Gjatë gjithë vitit 2021
Accessible Quality Healthcare	Trajnimi për Trajner TOT	Prill-Nëntor 2021
Fakulteti i Mjekësisë	Cikël i ligjëratave me mjek shqiptar nëpër botë	Janar-Dhjetor 2021
Kolegji i Kirurgëve të Kosovës	International Grand Rounds "Surgical Leadership & Quality Course"	Janar-Dhjetor-2021
Asociacioni i Hematologëve Kosovar	Simpozium – Updates in Hematology CML, MPNs	29 Janar 2021
Klinika e Hematologjisë	Ligjërata vjetore profesionale	Janar-Dhjetor 2021
Spitali i përgjithshëm Prizren	Ligjërata vjetore profesionale	Janar-Dhjetor 2021
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Viti	Ligjërata vjetore profesionale	Janar-Dhjetor 2021
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Podujevë	Ligjërata vjetore profesionale	Janar-Dhjetor 2021
Community Development Fund CDF	Trajnim për menaxhimin e TB në KPSH	Prill- Dhjetor 2021
Klinika e Oftalmologjisë	Ligjërata profesionale	Shkurt-Maj 2021
Shoqata e Urologëve të Kosovës	Ligjërata profesionale	Shtator-Nëntor 2021
Spitali i përgjithshëm Gjilan	Ligjërata profesionale	Shkurt-Dhjetor 2021
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Ferizaj	Ligjërata profesionale	Janar-Dhjetor 2021
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Prizren	Ligjërata profesionale	Shkurt-Dhjetor 2021
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare urgjenca Prizren	Ligjërata profesionale	Janar-Dhjetor 2021
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Junik	Ligjërata profesionale	Janar-Dhjetor 2021
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Mitrovicë	Ligjërata profesionale	Janar-Dhjetor 2021
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Dragash	Ligjërata profesionale	Janar-Dhjetor 2021
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Skënderaj	Ligjërata profesionale	Mars-Dhjetor 2021
AQH - OBSH	Pen protocols	Qershor-Shtator 2021
Klinika e Neonatologjisë	Ligjërata profesionale	Prill-Dhjetor 2021
Instituti I Evropës Juglindore për Politika Shëndetësore dhe Sociale	Konferencë	18 Shtator 2021
Klinika e Pediatriës	Ligjërata profesionale	Janar-Dhjetor 2021
Klinika e Infektivës	Ligjërata profesionale	Janar-Dhjetor 2021
Hermes Pharma Group	Aptos Threads, Methods and Therapeutics	23 Prill 2021
Oda e Mjekëve të Kosovës	Kongresi i II vjetor multidisiplinar me fokus onkologjinë	15-16 Tetor 2021
Oda e Mjekëve të Kosovës	Kongres multidisiplinar me fokus COVID-19	18-20 Nëntor 2021
	Dita Botërore e Goditjeve Cerebrale	29 Tetor
	Dita Botërore e Shëndetit Mendor	10 Tetor
	Muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit	Tetor
	Dita Botërore e Diabetit	14 Nëntor



Revista Mjeku

Monumenti përkujtimor për nderë të profesionistëve shëndetësorë

Që nga themelimi i spitalit të parë Kosovë, bazuar në të dhënat historike në vitin 1327, vazhduar me 1342 dhe me mjekun e parë në Kosovë me origjinë italiane Medicus Prizrensis, punëtorët shëndetësorë në periudha të ndryshme historike, ashtu si dhe vet popullata e Kosovës, kanë jetuar dhe vepruar me sakrificë të përditshme.

Okupatorët që vinin e ndërroreshin, asnjëherë nuk u munduan që kësaj popullate t'i ofroreshin shërbime shëndetësore, ashtu siç shënon në shkrimet saj Miss.Durham, ku konstaton se "As otomanët nuk kishin investuar në infrastrukturë ose ato ishin të pakta, e mos të flasim për investimet në mbrojtjen shëndetësore", kështu vetëm në vitin 1872 llogaritet si hapja e spitalit të parë në Kosovë gjatë pushtimit turk.

Edhe pas luftës së dytë botërore, Kosova ishte lënë në mëshirën e sunduesve të rinj, Epoka e komunizmit filloi me 9 mjekë (jo shqiptar), 15 farmacistë, 6 teknik mjekësor, 11 higjienistë dhe 23 punëtorë tjerë shëndetësor, me kualifikim të ulët shëndetësor. Pra për popullatën përkujdesej një mjek në 79000 banorë dhe në tërë territorin e Kosovës ka punuar vetëm një stomatolog.

Difteria, Tuberkulozi, Kala Azari, Tifoja Abdominale, Meningjitet, Fruthi, Kolla e bardhë dhe sëmundjet tjera vrastare ngjitëse po shfarosnin fëmijë dhe të rinjë në Kosovë. Çdo i dyti varr ishte i fëmijëve të vdekur nga sëmundjet ngjitëse, kjo si pasojë e përkujdesjes diskriminuese shëndetësore nga sundimtarët e rinjë.

Se sa ishin të drejtat e barabarta në Kosovë tregon një nga të dhënat e vitit 1963, prej 300 mjekëve në Kosovë, 50 nga ta ishin shqiptar dhe 333 punëtorë tjerë shëndetësor, ndërsa struktura e përbërjes së popullsisë ishte 74% në favor të popullsisë shqiptare.

Me themelimin e Fakultetit të Mjekësisë në 17 Qershor të vitit 1969, akt i cili ndryshoi dhe ndriçoi horizontet e mjekësisë në Kosovë duke i dhënë fund diskriminimit arsimor të këtij lloji.

Mjekët dhe punëtorët shëndetësorë, si shtresë e re intelektuale, që nga vitet e '60-ta deri në vitet '90, u bënë hale në sy, të regjimit. Mjekët përndiqeshin, burgoseshin por asnjëherë nuk dorëzoheshin apo nuk u bënëin mashë e regjimit.

Punëtorët shëndetësorë ishin në ballë të përkujdesjes të të lënduarve dhe plagosurve të demonstratave '68,'81, edhe helmimeve të nxënësve shqiptar e të demonstratave demonstratave të '89. Punëtorët shëndetësor dhe Fakulteti i Mjekësisë ishin të parët në goditjet shoviniste të viteve '90, por ata nuk u ndalën në organizimin e mbrojtjes shëndetësore të popullatës. Punëtorët shëndetësor arritën që të përballojnë rreziqet dhe të organizojnë spitalet ushtarake në të gjitha zonat operative të UÇK-së, ju qëndruan pranë ushtarëve dhe civilëve të plagosur ku disa edhe ranë në altarin e lirisë.

Pas luftës së UÇK-së, ne u ngritëm si feniksi dhe bëmë të pamundurur në ringritjen e sistemit dhe

institucioneve shëndetësore të rënuara në themele, kjo që të vijë dita të përballemi me pandeminë e Covid-19 duke e paguar me shumë jetë.

Iniciativa për ngritjen e një obelisku në nderim të punës dhe sakrificës së punëtorëve shëndetësorë, u ndërmor nga vet Kryetari i OMK-së, qysh në Tetor 2020. Pas dhënies së mbështetjes për një iniciativë të tillë nga ana e Këshillit Drejtues të OMK-së u bë thirrje për bashkëpunim dhe përkrahje nga Odat e Profesionistëve Shëndetësor ku edhe ato u shprehën të gatshme për të bërë ç'është e nevojshme për realizimin e këtij projekti.

Odat e Profesionistëve Shëndetësor (OPSh), pas dakordimeve të detaleve të projektit, i janë drejtuar Kryetarit të Komunës së Prishtinës, me kërkesën për ndarjen e një hapësire për ndërtimin e këtij obelisku.

Ky projekt ka gëzuar menjëherë përkrahjen e Kryetarit të Komunës dhe kështu në muajin maj 2021, Kuvendi Komunal i Prishtinës gjithashtu aprovoi projektin dhe ndau parcelën e kërkuar nga OPSh-të.

Obesliku është paraparë të ketë formën klasike, që pasqyron shtyllën e shtetit si dhe me përmasa të përafërta 2.5 metra i gjerë dhe deri në 10 metra i gjatë, kjo në vartësi prej projekteve konkurruese.



GJENI RRUGEN E TYRE INDIVIDUALE

Zbuloni një rrugë përpara për planin e trajtimit të pacientëve me kancer – duke përdorur të dhëna të fuqishme dhe gjithëpërfshirëse të profilit gjenomik nga Foundation Medicine¹⁻⁶

Vizitoni [rochefoundationmedicine.com](https://www.rochefoundationmedicine.com)

1. Frampton GM *et al.* *Nat Biotechnol* 2013; 31: 1023-1031; 2. Woodhouse R *et al.* *PLoS One* 2020; 15: e0237802; 3. He J *et al.* *Blood* 2016; 127: 3004-3014; 4. FoundationOne[®] CDx Technical Specifications, 2019. Available at: <https://www.foundationmedicine.qarad.eifu.online/foundationmedicine/en/foundationmedicine> (Accessed February 2021); 5. FoundationOne[®] Liquid CDx Technical Specifications, 2020. Available at: <https://www.foundationmedicine.qarad.eifu.online/foundationmedicine/en/foundationmedicine> (Accessed February 2021); 6. FoundationOne[®] Heme Technical Specifications, 2019. Available at: <https://www.foundationmedicine.qarad.eifu.online/foundationmedicine/en/foundationmedicine> (Accessed February 2021).

Foundation Medicine[®] and FoundationOne[®] are registered trademarks of Foundation Medicine[®], Inc. Roche is the licensed distributor of Foundation Medicine[®] products outside of the United States. M-XX-00004261 Date of preparation: February 2021.

Shiko më shumë, bëj më shumë



KOSOVO, Laboratori Nucleus
Rr. Mati 1, B-Relax, V-Hyrja 1, Prishtinë,
nucleus.patologjia@gmail.com

ALBANIA, Laboratori Diagnostik Morfologjik LDM
Rr e Dibres, Kompleksi Halli, Tiranë
<https://www.foundationmedicine.al/>

